



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 467 Akti

Nr. 332 Vendimi
Tiranë, më 12.1.2021

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Anëtare
Xhensila Pine	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 8.1.2021, ora 11:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Lindita Male (Ziguri)**, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e pranishme në seancën dëgjimore.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH” dhe “E”, të Aneksit të Kushtetutës;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi çështjen, mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Lindita Male (Ziguri) është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si prokurore. Në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), u shortua në datën 16.12.2019. Relatore e çështjes u zgjodh, sipas shortit, komisionere Xhensila Pine dhe anëtarë komisionerët Olsi Komici

dhe Valbona Sanxhaktari. Trupi gjykues ka zgjedhur kryesues për këtë çështje komisionerin Olsi Komici. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Tonci Petkoviç.

3. Më tej, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, i cili ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

4. Janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Subjekti është kontaktuar nëpërmjet adresës elektronike, të deklaruar për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua pyetëtori i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera gjatë hetimit administrativ.

5. Në datën 19.11.2020, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, ta ftojë atë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin edhe e konfirmoi. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit të Komisionit.

7. Komisioni, pasi ka marrë provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), si dhe ka pranuar dhe administruar të gjitha provat shkresore të paraqitura, e ftoi në seancën dëgjimore, datë 8.1.2021, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 11.1.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic.

9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtrori qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit. Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për znj. Lindita Male (Ziguri) në seancën e datës 12.1.2021, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe kanë të drejtë të çmojnë sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse¹.

¹ Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, "41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacion të përditësuar nga institucionet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumente shpresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- ë) denoncimet nga publiku.

A. VLERËSIMI I PASURISË

14. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm me konkluzionin se në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri):

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mosdeklarime ndër vite dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore (DPV) dhe atë të rivlerësimit kalimtar (deklarata *Vetting*), të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shpresore të administruara në këtë dosje, si dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për pasuritë e këtij subjekti dhe personave të lidhur me të, duke i vlerësuar ato njëra pas tjetrës sipas radhës së deklaratimit të subjektit në deklaratën *Vetting*, kanë rezultuar pasuritë si vijon.

1. Apartament banimi me sip. 68.8 m², në rr. “****”, Tiranë

1.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “...apartament banimi me sipërfaqe 68.8 m², në Tiranë, blerë në vitin 2008 në shumën 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro nga të cilat 30,000 (tridhjetë mijë) euro kredi, 5,000 (pesë mijë) euro hua pa kontratë dhe pa interes nga A.Gj. (daja), si dhe 3,000 (tre mijë) euro kursime nga të ardhurat nga puna; pronë individuale. Kontratë Shitblerje nr. *** rep., nr. **** kol., datë 4.4.2008, regjistruar në regjistrin hipotekor në ZVRPP-në Tiranë me nr. **, datë 24.4.2008, nr. pasurie ****. Pjesa takuese: 100%”.

1.2 Komisioni ka kërkuar informacion nga ASHK-ja² në datën 13.5.2020, e cila me shkresën kthim-përgjigje³, datë 27.7.2020, ka konfirmuar se në emër të subjektit figuron e regjistruar pasuria apartament me sip 68.8 m², z. k. **, vol. **, f. **. Në seksionin e hipotekave vendime

mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

² Me shkresën nr. *** prot., të datë 13.5.2020, dhe përgjigje e ASHK-së nr. *** prot., datë 27.7.2020.

³ Me shkresën kthim-përgjigje, nr. *** prot., datë 27.7.2020, të ASHK-së Tirana-Veri.

të gjykatës dhe kufizime në kartelën e kësaj pasurie, rezultojnë shënimi: “...në favor të “BK Greqisë” për shumën 30,000 (tridhjetë mijë) euro...ins 883/08...”.

1.3 Komisioni ka administruar në shkresën kthim përgjigjeje të ASHK-së,⁴ Kontratën e Shitjes së Pasurisë së Paluajtshme nr. **** rep., nr. *** kol., datë 4.4.2008, midis palës shitëse “****” sh.p.k. dhe palës blerëse subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male, sipas së cilës *regjistrimi i kësaj pasurie është bërë në emër të subjektit në datën 17.4.2008*”.

1.4 Nga historiku i regjistrimit të kësaj prone duket se apartamenti në fjalë ka qenë në pronësi të shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., duke u regjistruar nga data 21.1.2007 në emër të tyre dhe në datën 29.7.2007, nga këto shoqëri ka kaluar në pronësi të z. V. N., veprim i cili është bërë në bazë të një kontrate shitblerjeje dhe rezultojnë se kjo pronë është reregjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. në datën 10.1.2008 dhe më 17.4.2008 është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

1.4.1 FSHU-ja me shkresën kthim përgjigjeje⁵, datë 22.5.2020, ka konfirmuar se me gjeneralitetet Lindita Male referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit me Nr. **** në instancën e Tiranës, për adresën rr. “*****”, ***. Sipas informacionit mbi abonentin, data e kontratës është 21.12.2006.

1.4.2 Nga sa më lart, apartamenti me sip. 63.8 m² në rr. “****”, është blerë nga subjekti me Kontratën e Shitblerjes nr. **** rep., nr. ***kol., datë 4.4.2008, ku konfirmohet kryerja e pagesës së plotë, lidhja e kontratës së energjisë është bërë nga dhjetori i vitit 2006, dhe regjistrimi i kësaj pasurie është bërë në emër të subjektit në datën 17.4.2008. Faktet e mësipërme krijojnë dyshime mbi qëllimin e marrjes së kredisë, e cila duket se nuk ka shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie.

1.5 Mbi likuidimin e çmimit të shitjes për pasurinë apartament

1.5.1 Çmimi i shitjes sipas kontratës së shitjes të pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.4.2008, midis palës shitëse “****” sh.p.k. dhe palës blerëse subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male, është përcaktuar në vlerën 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro, në këtë kontratë është përcaktuar se: “...palët pranojnë se çmimi i kontratës u likuidua tërësisht...”.

1.5.2 Komisioni administroi deklaratën noteriale⁶, datë 20.5.2008, të lëshuar nga “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male, në të cilën palët kanë deklaruar, ndër të tjera, se: “...znj. Lindita Male...ka blerë një apartament nga shoqëria “****” sh.p.k., i cili ndodhet në rr. “****”, regjistruar në zonën kadastrale *** me numër regjistri hiptekor nr. ***, datë 25.3.2008. Vlera e apartamentit është 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro, u shlye tërësisht. Kësti i fundit u pagua sot në datën 20.5.2008”.

1.5.3 Komisioni, në pyetësin II, i ka kërkuar subjektit të saktësojë mënyrën e kryerjes/ekzekutimit të pagesave për blerjen e apartamentit me sip. 63.8 m² dhe paraqitjen e dokumentacionit provues për to. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se: “...në lidhje me shlyerjen e çmimit të shitjes, pati dakordësi me palën shitëse që paraprakisht të paguhej një këst dhe pjesa tjetër të shlyhej me kredi.

Në datën 15.4.2008 është bërë pagesa e këstit⁷ në vlerën 9,000 (nëntë mijë) euro, ku janë llogaritur me përafërsi dhe shpenzimet administrative që do të mbaheshin nga shuma e kredisë që do merrej në NGB në atë kohë në proces.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., 13.5.2020, dhe përgjigjen e ASHK-së nr. *** prot., datë 27.7.2020.

⁵ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.5.2020, nga FSHU-ja.

⁶ Deklarata Noteriale nr. ***rep., nr. *** kol., datë 20.5.2008, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe znj. Lindita Male në dosjen e ILDKPKI-së, f. **.

⁷ Mandat lëshuar nga shoqëria “****” nr. ***, datë 15.4.2008, shuma 9,000 euro me përshkrimin: “Arkëtim pjesor apartament rr. “****”.

Në datën 19.5.2008, me disbursimin e kredisë (në vlerën 30,000 euro), është bërë njëkohësisht edhe likuidimi i plotë i çmimit të shitjes së apartamentit dhe kthimi mbrapsht i diferencave të mbetura rreth 400 (katërqind) euro. Ndërtues i pallatit ishte vëllai i bashkëshortit por shitja është bërë me çmim tregu ...”.

1.5.4 Subjekti ka bashkëlidhur në përgjigje të pyetësorit II, mandatpagesë në shumën 9,000 (nëntë mijë) euro të datës 15.4.2008 në favor të shoqërisë “****”.

1.5.5 Referuar të dhënave të kontratës dhe historikut të regjistrimit të pronës duket se pagesa e këtij mandati është bërë në favor të një shoqërie, e cila nuk është pala shitëse e këtij apartamenti.

1.6 Mbi burimet e krijimit për pasurinë apartament

1.6.1 Kredi bankare marrë nga ish-NBG

i) Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008, se për këtë investim ka përdorur edhe huan bankare në vlerën 30,000 (tridhjetë mijë) euro nga NBG.

ii) Komisioni administroi Kontratën e Kredisë ⁸nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2008, në të cilën në nenin 1 është vendosur: “...banka bie dakord t’i japë kredimarrësve (Lindita Male dhe F.M.) një kredi në monedhën euro në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) euro, me qëllim blerjen e një apartamenti me adresë në rr. ”***”, Tiranë, pjesëmarrja e e kredimarrësve në këtë investim është në shumën 8,000 (tetë mijë) euro. Shuma e kredisë do të disbursohet me 1 këst...”.

iii) Nga dokumentacioni i administruar⁹ nga “ABI Bank” (ish-NBG), datë 18.5.2020, konfirmohet se subjektit i është disbursuar një kredi në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) euro për blerje apartamenti në datën 19.5.2008 dhe brenda ditës një shumë prej 29,446 (njëzetë e nëntë mijë e katërqind e dyzetë e gjashtë) euro, është transferuar nga llogaria e subjektit te një llogari në Bankën Popullore me përshkrimin: “Blerje apartamenti sipas Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. ***kol., nga Lindita Male, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***”.

iv) Komisioni administroi Deklaratë Noteriale¹⁰, datë 20.5.2008, të lëshuar nga “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male, në të cilën palët kanë deklaruar ndër të tjera: “... znj. Lindita Male, ka blerë një apartament nga shoqëria “****” sh.p.k., i cili ndodhet në rr. “****”, regjistruar në zonën kadastrale *** me numër regjistri hiptekor nr. **, datë 25.3.2008, me numër pasurie nr. *** z. k. **, vol. **, f. **, shk. ***, k. ***, ap. ***, me sipërfaqe shfrytëzimi 68.8 m² dhe sip kolektive 9.5 m², sip totale 78.3 m² përbërë nga garsoniere në katin e dytë të banimit të godinës 8-katëshe në rr. “****”. Vlera e apartamentit është 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro dhe u shlye tërësisht. Kësti i fundit u pagua sot, në datën 20.5.2008”.

v) Komisioni vlerësoi të marrë në konsideratë me rezervë kredinë bankare si burim krijimi, duke i kërkuar subjektit shpjegime lidhur me mospërputhjet në kohë të kryerjes së veprimeve ligjore për apartamentin me sip. 63.8 m² në rr. “****”.

1.6.2 Hua në vlerën 5,000 (pesë mijë) euro pa kontratë dhe pa interes nga z. A. Gj.

i) Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008, se për këtë investim (apartament me sip. 68.8 m² në rr. “****”, Tiranë), ka përdorur edhe huan në vlerën 5,000 (pesë mijë) euro nga daja i saj, z. A.Gj..

ii) Në DPV-të për vitet 2009 – 2015, subjekti ka deklaruar lidhur me këtë hua, deklarime të cilat janë reflektuar në analizën financiare të Komisionit.

⁸ Ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

⁹ Shkresë kthim përgjigje nr. ***, datë 18.5.2020, lëshuar nga ABI Bank (ish-NBG).

¹⁰ Deklarata Noteriale nr. *** rep., nr. ***kol., datë 20.5.2008, nga “****” dhe znj. Lindita Male në dosje ILDKPKI-së.

iii) Komisioni ka pyetur subjektin në pyetëtorin I, në lidhje me huat e mara nga persona të tjerë dhe dokumentacionin provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit.

iv) Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka deklaruar se: “...kam marrë hua në shumën 5.000 (pesë mijë) euro, në prill të vitit 2008, nga z. A. Gj. (vëllai i nënës). Kjo shumë më është dhënë hua nga daja pa interes dhe në dakordësi për fillimin e shlyerjes me vonesë dhe pjesë-pjesë, ndër vite, sipas mundësisë sime. Shuma është likuiduar totalisht në korrik të vitit 2015. Bashkëlidhur dokumentacion provues si më poshtë: (1) Deklaratë Noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 12.9.2019, me deklarues A.Gj. dhe Lindita Male (Ziguri); (2) dokumenti 2: certifikatë personale dhe familjare A.Gj.; certifikatë personale M.Z.i; Licencë Arkitekt në projektim *** dhe Licencë Arkitekt në Zbatim ***; ekstrakt i regjistrit tregtar për “***” sh.p.k. me administrator A.Gj.; vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare për L.Gj. dhe Xh.Gj. për vitet 2006, 2007 dhe 2008, që tregojnë të ardhurat nga paga; librezat respektive të punës dhe librezat e kontributeve për L.Gj.; (3) Nxjerrje Llogarie nga “Raiffeisen Bank” dega **** (****) datë fillimi 14.9.2007 dhe datë mbarimi 31.12.2012 për A.Gj. ”.

v) Komisioni përgatiti analizën financiare për të ardhurat e deklaruara nga personi tjetër i lidhur, z. A.Gj., së bashku me dy familjarët e tij L.Gj. dhe Xh.Gj. ku u morën në konsideratë:

- të ardhura nga paga e kaluar në bankë në favor të z. A.Gj. për periudhën shtator 2007 – mars 2008, sipas lëvizjeve të llogarisë në “Raiffeisen Bank”;
- të ardhura nga paga bruto minimale e Xh. dhe L.Gj. të punësuar në shoqërinë “*****” sh.p.k., me NIPT ****, sipas vërtetimit të lëshuar nga punëdhënësi;
- librezë pune për periudhën 1.3.2006 – 07.11.2008, për L.Gj. e punësuar në shoqërinë “*****” sh.p.k.;
- librezë pune për periudhën 1.3.2006 – 10.12.2008, për Xh.Gj. i punësuar në shoqërinë “*****” sh.p.k.

vi) Shoqëria “*****” sh.p.k., me NIPT ***, me administrator dhe ortak të vetëm z. A.Gj., sipas informacionit të marrë nga Komisioni në faqen zyrtare të QKB-së¹¹, duket se në vitin 2007 ka rezultuar me një humbje të deklaruar nga ushtrimi i aktivitetit në shumën -421,671 lekë.

vii) Nga kjo analizë, duke mos marrë në konsideratë investimet që mund të jenë kryer nga ana e personave të tjerë të lidhur, rezulton se shuma e të ardhurave edhe nëse konsiderohen se për to është kryer pagesa e detyrimeve tatimore, është thuajse në të njëjtën vlerë me shpenzimet jetike për familjen e huadhënësit për 3 anëtarët. Për rrjedhojë, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues se personi tjetër i lidhur, z. A.Gj., ka pasur mjete financiare të ligjshme që mund të shërbenin për huan në vlerën 5,000 (pesë mijë) euro në prill të vitit 2008.

viii) Për rrjedhojë, ky burim nuk është përllogaritur në analizën financiare në momentin e blerjes së pasurisë tip apartament.

Komisioni përgatiti analizën financiare në datën 4.4.2008 të blerjes të apartamentit dhe për të gjithë vitin financiar 2008.

1.6.3 Nga sa më lart për këtë pasuri duket se:

i) Kredia e marrë në vlerën 30,000 (tridhjetë mijë) euro pranë ish-NBG-së në datën 19.5.2008, nuk mund të përllogaritet në analizën financiare (në datën e blerjes 4.4.2008), duke qenë së palët kanë deklaruar se janë likuiduar në datën 4.4.2008 përpara se të disbursohet kredia në bankë në datën 19.5.2008.

¹¹ <http://www.qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrit-tregtar/kerko-per-subjekt/>

ii) Huaja e deklaruar në shumën 5,000 (pesë mijë) euro, si e marrë nga personi tjetër i lidhur, z. A.Gj., nuk është konsideruar në analizën financiare, pasi nuk duket të jetë mbështetur në aftësinë financiare të personit tjetër të lidhur për të dhënë huan.

iii) Pagesa e deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit II, datë 15.4.2008, në shumën 9,000 (nëntë mijë) euro është kryer në favor të shoqërisë “****”, e cila nuk është pala shitëse e apartamentit.

iv) Subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të investuar në këtë pasuri, apartament në çmimin 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro, duke rezultuar më një balancë negative në shumën 4,667,868 (katër milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë, në datën 4.4.2008.

v) Duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në vitin 2008 duke rezultuar më një balancë negative në shumën 1,006,828 (një milion e gjashtë mijë e tetëqind e njëzetë e tetë) lekë.

1.7 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit lidhur me këtë pasuri.

1.8 Subjekti rivlerësimi ka shpjeguar se: *“Për sa i përket kontratës së furnizimit me energji elektrike Nr. ****, datë 21.12.2006 për apartamentin *** në rr. “****”, nuk kam lidhur/nënshkruar asnjëherë kontratë me OSHEE-në dhe se likuidimi i faturave ka vijuar me të njëjtin numër kontrate (T***) që ishte lidhur më parë me furnizuesin e energjisë nga ish-pronari “****” sh.p.k., duke u bërë vetëm ndryshimi i emrit pas blerjes së pronës në datën 4.4.2008. Libreza e energjisë elektrike që i përgjigjet kësaj kontrate pasqyron pagesa të kryera duke filluar nga data 10.12.2008, pra, pas blerjes së apartamentit dhe jo më parë. Po kështu faturimi i konsumit të ujit për kontratën nr. ***, “Për furnizimin me ujë”, të lidhur me UKT-në, deri në dhjetor të vitit 2019, është bërë në emër të pronarit të mëparshëm “****” sh.p.k., megjithëse pagesat kanë filluar të kryhen nga ana jonë pas blerjes së apartamentit në vitin 2008.*

*Përgjigja e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU), nr. *** prot., datë 22.5.2020, që i referohet të dhënave në sistemin e faturimit, sugjeron për marrjen me rezervë të të dhënave, pasi nuk sigurojnë saktësinë e plotë të tyre për shkak të kushteve rregullatore të mëparshme të regjistrimit të abonentëve. Po ashtu, dhe në përgjigjen që FSHU-së ka kthyer me shkresën nr. *** prot., datë 17.12.2020, informacioni i referohet sistemit të faturimit që paraqet të dhëna në kohë reale dhe jo një kontrate fizike të datës 21.12.2006.*

*Nuk kam banuar asnjëherë në apartamentin **** (***) dhe pagesat e konsumit të energjisë dhe ujit për këtë banesë janë bërë nga nëna ime, M. Z., e cila gjatë gjithë kohës ka banuar aty. Familjarisht kam banuar pa ndërprerje në apartamentin ***, në pallatin ****, që mbajmë në përdorim prej vitit 2007.*

*Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës: (i) fotokopje e librezës së energjisë për apartamentin ***; (ii) fotokopje e librezës së ujit për ap. ***; (iii) faturë uji lëshuar nga UKT-ja, datë 31.12.2019, për apartamentin ***; (iv) përgjigjja e FSHU-së me nr. *** prot., datë 17.12.2020.*

*Në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes për pasurinë apartament të blerë me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.4.2008, ku thuhet se “... palët pranojnë se çmimi i kontratës u likuidua plotësisht”, shpjegoj s, në momentin e lidhjes së kontratës nuk është kryer asnjë pagesë, vërtetuar kjo dhe me faktin se kontratës noteriale nuk i bashkëlidhet asnjë mandatpagesë. Kontrata e Shitblerjes është gjetur gati prej meje dhe e nënshkruar nga pala shitëse. Kam nënshkruar kontratën nxitimthi pa iu përmbajtur detajeve, për shkak të gjendjes time jo të mirë shëndetësore për të cilën më ishte dhënë dhe raport mjekësor 15 ditor nga data 2.4.2008*

– 17.4.2008. Bashkëlidhur: raporti nr. *** serial, nr. *** regjistri, datë 2.4.2008 nga Komisioni Mjekësor në QSUT.

Çmimi i blerjes prej 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro i apartamentit është paguar vetëm në dy këste: 1. Pagesë kësti me mandatin nr. 48, datë 15.4.2008, në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k., në favor të palës shitëse shoqërisë “****” sh.p.k., konfirmuar me Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2008, të përfaqësuesit me Prokurë të Posaçme të shoqërisë “****” sh.p.k (e pa dorëzuar më parë prej subjektit), që konfirmon pagesën 8,000 (tetë mijë) euro të këstit të parë. 2. Transferimi i fondit të kredisë prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro, në datën 19.5.2008, nga NBG në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. në ish-Banka Popullore, konfirmuar me Deklaratën Noteriale nr. ** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2020, të përfaqësuesit me Prokurë të Posaçme të shoqërisë “****” sh.p.k., që rikonfirmon likuidimin tërësisht të çmimit të blerjes.

Deklarata Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.5.2008, e hartuar pas aplikimit “Kërkesë për transferim fondesh brenda dhe jashtë vendit”, në datë 19.5.2008, në NBG për fondin kredi në vlerën 30,000 (tridhjetë mijë) euro, së bashku me pagesën e këstit me mandatin nr. ***, datë 15.4.2008, vërtetojnë shlyerjen e plotë të çmimit të blerjes së apartamentit prej 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro, me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.4.2008.

Në deklaratën Vetting të vitit 2017, nisur nga fakti se kam deklaruar rregullisht çmimin e blerjes 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro, si dhe kam dorëzuar dokumentacion për shlyerjen plotësisht të çmimit brenda periudhës së shitblerjes, duke përfshirë edhe transferimin e fondit kredi të shitësi, e kam arsyetuar se kam deklaruar në përputhje me kërkesat e formularit të deklarimit.

Pagesa e këstit të parë me mandatin nr. ***, datë 15.4.2008, është bërë në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k., por ka shkuar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., fakt që konfirmohet edhe në Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2008, të nënshkruar nga të dy palët.

Bashkëlidhur, Deklarata Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.12.2020, e shoqërisë “****” sh.a. (ish “*****” sh.p.k.), që rikonfirmon mënyrën e shlyerjes së çmimit të blerjes vetëm me dy këste.

Mbi burimet e krijimit për pasurinë apartament, financimi për të investuar në pasurinë apartament deri në datën 20.5.2008 është mundësuar me kredinë bankare në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) euro, me shumën 5,000 (pesë mijë) euro të marrë hua dhe me shumën 3,000 (tre mijë) euro kursime të miat.

a- Gjithë shuma e kredisë e miratuar nga ish-NBG me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2008, i është transferuar palës shitëse shoqërisë “****” sh.p.k. me NIPT ***, me një këst të vetëm në datën 19.5.2008, në numrin e llogarisë së saj në ish-Bankën Popullore. Dokumenti bankar me datë 19.5.2008, “Kërkesë për transferim fondesh brenda dhe jashtë vendit”, hartuar ditën e disbursimit të kredisë paraqet në përmbajtje të rubrikës “Detaje të pagesës” - blerje apartamenti sipas Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., nga Lindita Male.

b- Lidhur me huan në shumën 5,000 (pesë mijë) euro pa kontratë dhe pa interes nga daja, z. A.Gj., është fakt marrja dhe likuidimi i saj pjesë-pjesë dhe me shtrirje kohore, gjë e cila është llogaritur dhe në analizën tuaj në shpenzimet e mia vjetore për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Shuma përfaqëson kursime familjare ndër vite. Bëhet fjalë për një person në marrëdhënie pune prej 37 vjetësh përfshirë edhe aktivitet privat. Në marrëdhënie pune ka qenë dhe bashkëshortja, znj. B. Gj., me rreth 33 vjet punë, të ardhurat e së cilës nuk janë përfshirë në bilancin familjar, si dhe fëmijët e tij nga të cilët njëri me banim prej vitesh në SHBA. Bilanci financiar i familjes së dajës i përgjigjet një periudhe të reduktuar kohore të marrëdhënieve të tij punës, me aq dokumentacion sa kam mundur të mbledh dhe të dorëzoj para kryerjes së tij, në pamundësi për t'i

*siguruar të plota në kohë, meqenëse prej rreth 5 vjetësh është rezident jashtë shtetit. Meqenëse kam mundur të administroj dokumentacion shtesë për të ardhurat familjare të dajës, z. A.Gj., dhe bashkëshortes znj. B. Gj., të pallogaritura më parë në bilancin familjar të tij, kërkoj që të merret në shqyrtim nga ana juaj. Vërtetohet shlyerjen e kështit të fundit të huas, nëpërmjet mandatit Nr. ***, datë 2.7.2015, të tërheqjes nga llogaria e ime e pagës në “Credins Bank” të shumës së parave që po atë ditë është konvertuar në Exchange “****” sh.p.k., në vlerën 1,000 (një mijë) euro, fakt që e konfirmon edhe z. A.Gj., në Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.9.2019, ku ndër të tjera, përmend si kohë likuidimi përfundimtar të huas korrik të vitit 2015. Bashkëlidhur, dokumentacion i marrë në Degën e Arkivit të Rajonit Tiranë dhe Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë me kërkesë/shkresën me nr. ** prot., datë 1.12.2020 dhe Akti i Ekspertimit Kontabël me datë 18.12.2020.*

*c- Shuma 312,472 (treqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë e përdorur, gjithashtu, si burim për blerjen e apartamentit, ka qenë gjendje në llogarinë time të pagës nr. ***, datën 31.12.2006, në “Raiffeisen Bank”, që është tërhequr dhe mbajtur cash prej meje në vitin 2007. Duke qenë llogari e pagës sime të ligjshme të marrë nga detyra si prokurore dhe hedhur nga institucioni ku punoj, kam parë si të panevojshëm deklarin si kursim, pasi e kam konsideruar vlerë të kontrollueshme duke qenë se bëhet fjalë për mbetje të pagës dhe të vënë në dijeni. Nuk e kam deklaruar kursim duke menduar se kuptohej që ishte e tillë, sepse gjithçka është transparente. Më pas, si pasojë dhe e udhëzimeve të nxjerra nga ILDKPKI-ja, kam deklaruar gjithçka. Fakti që shuma ka ekzistuar dhe pranohet në pyetjen tuaj, nuk mund të mos më llogaritet, pasi është parë e fituar nga puna dhe mosdeklarimi në deklaratë nuk e fshin apo shuan atë.*

Plotësimi i shumës 3,000 (tre mijë) euro për blerjen e apartamentit është mundësuar edhe nga kursime të tjera deri në prill të vitit 2008.

Për sa i përket mundësive financiare për të përballuar shpenzimet në vitin 2008 theksoj se jetesa ime ka qenë gjithmonë modeste prandaj edhe shpenzimet e jetesës kanë qenë në limitet minimale të nivelit të jetesës.

*Bashkëlidhur: përgjigja nr. *** prot., datë 22.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”; vërtetim procesverbali me datë ***; dhe pyetja **, f. ***, mbajtur në ILDKPKI-ja, të dërguara nga institucionet respektive mbi kërkesën tuaj.”.*

1.9 Në përfundim, trupi gjykues, pasi vlerësoi provat dhe faktet e paraqitura nga subjekti rivlerësimi, si dhe dëgjoi shpjegimet e saj, arrin në konkluzionin se shpjegimet dhe provat e paraqitura lidhur me kryerjen prej nënës së subjektit, të pagesave të energjisë elektrike dhe ujit, janë bindëse dhe provojnë plotësisht faktin se apartamenti ka filluar të përdoret prej nënës së saj në vitin 2008 dhe jo që prej vitit 2006.

1.10 Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit dhe likuidimin e çmimit të shitjes së kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit ishin bindëse dhe se rezultoni e provuar që kredia është përdorur për blerjen e kësaj pasurie. Lidhur me huan në vlerën 5,000 (pesë mijë) euro, pa kontratë dhe pa interes nga daja i subjektit, z. A. Gj., trupi gjykues, pasi vlerësoi dokumentacion e paraqitur nga subjekti, arrin në konkluzionin se ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për dhënien e kësaj huaje. Po ashtu, rezultoni e deklaruar marrja dhe shlyerja e saj edhe në DPV-të e subjektit të rivlerësimit.

1.11 Lidhur me shumën 3,000 (tre mijë) euro, për plotësimin e shumës totale për blerjen e apartamentit, trupi gjykues, vlerëson se shuma prej 312,472 (treqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë gjendje në llogarinë e pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank”, në datën 31.12.2006, e tërhequr dhe e mbajtur cash në vitin 2007, dhe e përdorur në vitin 2008,

dhe e padeklaruar nuk mund të pranohet nga Komisioni, pasi nuk është deklaruar as si burim në deklarinimin *Vetting* dhe as si kursim *cash* i mbajtur në banesë, në DPV-të përkatëse.

1.12 Nga analiza financiare për vitin 2008, subjekti rezulton me një balancë negative të tillë, e cila nuk mund të vlerësohet se e klasifikon subjektin e rivlerësimit në ndonjë nga kushtet e nenit 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2018, duke vlerësuar, gjithashtu, me rezervë shpenzimet jetike në raport me jetën modeste të subjektit të rivlerësimit, të rezultuar gjatë hetimit.

2. Pasuria apartament banimi me sip. 48 m², ndodhur në Përmet

2.1 Apartament banimi, me sipërfaqe 48 m², në Përmet, blerë në datën 8.7.1993, në shumën 7,574 (shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, në bashkëpronësi, pjesë takuese 1/3, krijuar nga privatizimi i ish-banesave shtetërore, regjistruar në ZVRPP-në Përmet, në datën 14.9.2005, me nr. *** pasurie, rivlerësuar në datën 3.5.2012. Vlera: 1.202.880 (një milion e dyqind e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë. Pjesa takuese: 33.33%.

2.2 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “...apartament banimi, me sipërfaqe 48 m², në qytetin e Përmetit, blerë në datën 8.7.1993, në shumën 7.574 (shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, në bashkëpronësi, pjesë takuese 1/3, krijuar nga privatizimi i ish-banesave shtetërore, regjistruar në ZRPP-në Përmet në datën 14.9.2005, me nr. *** pasurie, rivlerësuar më 3.5.2012. Vlera: 1.202.880 (një milion e dyqind e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë. Pjesa takuese: 33.33% ...”.

2.3 Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja Përmet rezulton së prona është pajisur me Certifikatë Pronësie në datën 14.9.2005 në emër të bashkëpronarëve M.Xh. B., L.D.B.dhe E. D.B. Në seksionin e kartelës përshkrim i veçantë për këtë pasuri rezulton të jetë shënuar se në datën 3.5.2012 është kryer rivlerësimi i pasurisë në shumën 1,202,880 (një milion e dyqind e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

2.4 Në seksionin e kartelës për pronësisë të datës 1.6.2020, rezulton që bashkëpronarët 1/3 secili janë M.Xh.Z., E.D.Ç. dhe L.D.M.

2.5 Komisioni ka administruar në dosjen e ILDKPKI-së¹² kontratën për privatizimin e banesës, datë 8.7.1993, midis Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe palës tjetër, znj. M.B. (nëna e subjektit). Objekti i kontratës është kalimi i pronësisë së apartamentit nr. ***, p. ***, shk. ***, i përbërë nga një dhomë dhe një kuzhinë, gjithashtu, ka paraqitur Vërtetimin Noterial nr. ** rep., nr. ** kol., datë 17.9.1993, për kontratën e lidhur midis Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe znj. M.B.

2.6 Çmimi i shitjes së pasurisë është përcaktuar në vlerën 7,574 (shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, ku palët deklarojnë se likuidimet janë kryer me mandatarkëtimin nr. ***, datë 9.7.1993. Komisioni administroi në dosjen e ILDKPKI-së¹³ një shkresë nga Bashkia Përmet në të cilën konfirmohet se: “Regjistri themeltar nr.**, f.**, të vitit 1974, Përmet, të prindërve të znj. Lindita Male (B.) i ati ka ndërruar jetë më 30.6.1985. Pra, familja B. e përbërë prej: nëna M., motra E. dhe vëllai G. me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. ***, datë 2.6.1995, ka ndryshuar mbiemrin në Z..”.

2.7 Nga sa më lart, duket se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, si pasuri në bashkëpronësi me familjarët e tjerë në pjesën takuese 1/3. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

¹² Shihni dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 17.11.2016, nga Bashkia Përmet drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2.8 Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën para fillimit të detyrës, subjekti ka shpjeguar se: *“Nuk është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003 për arsye harrese, megjithëse në bindjen time ka qenë gjithmonë se është deklaruar. Kjo ishte deklarata ime e parë dhe në atë kohë nuk kemi patur eksperiencën e duhur për plotësim, ndërkohë që nuk kishim orientime nga ILDKPKI-ja që sapo kishte filluar”*.

2.9 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se subjekti rivlerësimi e ka deklaruar saktë atë në deklaratën *Vetting* dhe mosdeklarimi i saj në DPV-në e vitit 2003 është dukshëm një pakujdesi e paqëllimshme nga subjekti i rivlerësimit.

Deklarimi i bashkëshortit të subjektit, z. F.M.

3. Pasuria apartament banimi *, me sip. *** m², në rr. “***”**

3.1 Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur ka deklaruar: *“Apartament banimi ***, në rr. “****”, me sip. 137.9 m², ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në përdorim familjar dhe pa qira nga viti 2007 pronë e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe “****” sh .a. Regjistruar në regjistrin hipotekor të ZVRPP-së Tiranë me nr. ***, datë 26.6.2007, me nr. pasurie, ***, z. k ***...”*.

3.2 Subjekti nuk ka deklaruar në asnjë nga DPV-të të drejtat reale mbi këtë pasuri.

3.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit në pyetësonin II dokumentacionin në lidhje me shërbimet utilitare të lidhura për këtë apartament.

3.4 Në përgjigje të pyetësonit II, subjekti ka paraqitur librezën e energjisë elektrike me pagesa të cilat fillojnë prej janar të vitit 2007 me nr. kontrate 1** në emër të personit të lidhur, z. F.M. dhe librezë uji në emër të shoqërisë “****” me nr. kontrate ***, “****”.

3.5 Komisioni ka pyetur subjektin në pyetësonin standard, në lidhje me adresat në të cilat ka jetuar gjatë ushtrimit të detyrës, i cili ka sqaruar se: *“...nga janari i vitit 2007 dhe aktualisht banoj në rr. “****”, Kompleksi ***, shk. *** k. ***, ap. ***, pronë e shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., me administrator B.M., vëllai i bashkëshortit. Banesa i është lënë në përdorim familjar bashkëshortit, pa afat, pa detyrim qiraje dhe pa asnjë detyrim tjetër...”*.

3.6 Subjekti ka paraqitur së bashku me përgjigjen e pyetësonit standard edhe një kontratë huapërdorje, datë 10.2.2007, midis palëve “****” sh.p.k. dhe z. F. M., ku midis të tjerave janë dakordësuar: *“Qëllimi i kontratës: shoqëria “****” sh.p.k. në bazë të lejes së ndërtimit nr. ***, datë 20.9.2005, ka ndërtuar objektin *** kate në rr. “***”, meqenëse ortaku i vetëm dhe përfaqësues ligjor i huadhënësit dhe huamarrësi janë pjesëtare të një familje, përkatësisht vëllezër, atëherë shoqëria “****” sh.p.k., jep në huapërdorje ambientin “apartament” në këtë pallat regjistruar më nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, me sip. 137.9 m² te z. F. M. dhe familja e tij. Huapërdorja i jepet huamarrësit pa kundërshpërblim ...”*.

3.7 Deklarimi i mësipërm i subjektit se në kohën e dhënies së apartamentit në huapërdorim, përfaqësuesi ligjor i huadhënësit ka qenë dhe ortak i vetëm, nuk është në përputhje me faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, për sa nga të dhënat e deklaruara në QKB¹⁴, në kohën e dhënies së apartamentit në huapërdorim shoqëria “****” sh.p.k., ka pasur dy ortakë: z. B. M. dhe z. F. Y. me nga 50% të pjesëve takuese secili dhe me vendim asambleje (datë 12.2.2004) është përcaktuar se fitimet, humbjet, të drejtat dhe detyrimet e lidhura nga aktiviteti i shoqërisë pas lidhjes së kontratës i takojnë të dy ortakëve përpjesëtimisht.

¹⁴ www.qkb.gov.al; në datën 12.2.2004 ortakut i vetëm i shoqërisë z. B.M. i ka shitur shtetasit F.Y. 50% të kuotave të tij në shoqëri sipas Kontratës së Shitblerjes së Kuotave me nr. **** rep., nr. **** kol., dhe vendimit nr. ***, datë 12.2.2004, të ortakut për miratimin e shitjes së 50% të kuotave.

3.8 Nga administrimi i kontratës së huapërdorimit, është evidentuar deklarimi i palëve në nenin 3 se: *“Palët bien dakord se gjendja aktuale e sendit “apartament” është bosh dhe mobilimi dhe sendet e tjera do të kryhen nga huamarrësi kur dhe si ta shohë ai dhe familja e tij të arsyeshme”*.

3.8.1 Në përgjigjet e dy pyetësorëve (I dhe II), lidhur me shpenzimet e mobilimit, subjekti ka deklaruar se: *“Shpenzimet për mobilimin e apartamentit, ku kam banuar dhe aktualisht banoj janë rreth 480.000 -500.000 lekë, pa përfshirë pajisjet elektrike të blera, ndër vite, të cilat i disponoja para se të hyja në këtë apartament, në janar të vitit 2007 (shihni përgjigjen e pyetjes 14 të pyetësorit të I-rë). Mobilimi i apartamentit është modest dhe i mundësuar kryesisht nëpërmjet një kredie të marrë në dhjetor të vitit 2006 te “Raiffeisen Bank”. Kostoja e mobilimit të apartamentit ka qenë rreth 480.000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë dhe nuk ka ndryshuar që prej janarit të vitit 2007 (shihni përgjigjen e pyetjes 11 të pyetësorit të II-të)”*.

3.9 Në nenin 4, “baza ligjore”, të kontratës së huapërdorimit është përcaktuar se: *“Dokumentet e Lejes së Ndërtimit dhe Lejes së Shfrytëzimit në favor të huadhënësit legjitimojnë nënshkrimin e kontratës”*.

3.10 Komisioni administroi dokumentacionin të paraqitur nga subjekti lidhur me apartamentin e dhënë në huapërdorim: Leje Ndërtimi nr. ***, datë 20.9.2005, me subjekt investitor shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., për objektin godinë banimi dhe shërbime *** dhe *** kate me *** kat parkim nëntokë, në rr. “****”, në pronë të z. V.N., në favor të subjektit ndërtues shoqërisë “****” sh.p.k.; Leje Shfrytëzimi nr. *** prot., datë 3.4.2007, për objektin godinë banimi dhe shërbime *** dhe ***kat me *** kat parkim nëntokë ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., investuar nga shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k.; lëshohet leje shfrytëzimi në favor të investitorit shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k.; vërtetim nga dokumentet hipotekore vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 26.6.2007, figuron e regjistruar në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe “****” sh. a., pasuria nr. ****, ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 137.9 m² (ap. ***), godina ***, rr. “****”, lëshuar në datën 17.5.2010.

3.11 Me qëllim vlerësimit e situatës ligjore, mbi bazën e deklaramit të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, lidhur me huapërdorimin e pasurisë së paluajtshme apartament, Komisioni iu referua dispozitave të Kodit Civil, sipas të cilit parashikohet:

Neni 143

Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e paluajtshme zbatohen edhe për të drejtat reale që kanë si objekt sende të paluajtshme.

Regjistrimi i sendeve

Neni 144

Sendet e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Neni 193

Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme: b) kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, të drejta uzufukti, përdorimi e bujtjeje, emfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale;

3.12 Nga vlerësimi i dispozitave të detyrueshme ligjore, duket se pasuria apartament është regjistruar për herë të parë në regjistrat publikë në datën 26.6.2007, ndërkohë i është dhënë në huapërdorim bashkëshortit të subjektit përpara se të regjistrohet, sipas kontratës së huapërdorimit me datë 10.2.2007.

3.13 Gjithashtu, nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, nuk duket që kontrata e huapërdorimit e datës 10.2.2007 të jetë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme nga huadhënësit.

3.14 Gjithashtu, nga vlerësimi i dokumentacionit nuk rezulton të jetë marrë pëlqimi dhe nga shoqëria “*****” sh.a., për huadhënien e kësaj prone ndaj z. F.M..

3.15 Për sa më sipër, duket se:

- i) Subjekti e ka përdorur këtë apartament që nga janari i vitit 2007, pa kundërshtim dhe pa ndërprerje.
- ii) Subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratimet periodike të saj këtë huapërdorje në afat të gjatë të këtij apartamenti, i cili krijonte të drejta reale për subjektin sipas kontratës së huapërdorimit të datës 10.2.2007, bazuar në nenin 4, të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
- iii) Shpjegimet e subjektit se kjo pasuri është pronë e shoqërisë “****” sh.p.k., nuk provohen nga dokumentacioni ligjor provues, nga i cili rezulton se ky apartament është, gjithashtu, edhe në pronësi të shoqërisë “*****” sh.a.
- iv) Shpjegimet e subjektit se ortaku i vetëm dhe përfaqësues ligjor i huadhënësit është vëllai i bashkëshortit nuk provohen me dokumentacion ligjor provues për sa edhe shoqëria “*****” sh.p.k., gjatë viteve të huapërdorjes 2004 – 2008 ka qenë edhe në pronësi të ortakëve të tjerë.
- v) Ka fakte kontradiktore lidhur me periudhën kur subjekti dhe bashkëshorti kanë filluar të banojnë në këtë apartament, që lidhen me hapjen e kontratës së furnizimit me energjinë elektrike që në janar të vitit 2007, deklarinin për shkak mobilimi të subjektit në pyetësorët e dërguar nga Komisioni se kostot e mobilimit janë kryer që në janar të vitit 2007, ndërkohë kontrata e huapërdorimit është lidhur në një datë të mëvonshme dhe sipas deklarinimit në datën e kontratës 10.2.2007, apartamenti ka qenë bosh.
- vi) Duket se ka pasur parregullsi ligjore në lidhjen e kontratës së huapërdorimit dhe respektimin e dispozitave ligjore të detyrueshme, për sa pasuria mbi të cilën janë krijuar të drejta reale nga subjekti dhe bashkëshorti nuk duket të jetë regjistruar më parë në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme nga huadhënësit, për sa kontrata e huapërdorimit nuk rezulton të jetë regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme nga huadhënësit.

3.16 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

3.17 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Për përdorimin e apartamentit nuk kemi bërë deklarime në deklaratimet periodike, pasi një kërkesë e tillë nuk kërkohet në formularin e deklarinimit. Gjithashtu, ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, neni 4, pika a dhe neni 21 përcakton si detyrim për të deklaruar vetëm pasuritë në pronësi ose në bashkëpronësi të subjektit të deklarinimit apo personit të lidhur.*

*Për sa i përket qenies së kësaj pasurie në pronësi apo bashkëpronësi të shoqërisë “***” sh.p.k., dijenia jonë si banorë të apartamentit në përdorim, në pallatin ***, kompleksi *** i përbërë nga disa seksione, ka qenë se secili pallat ishte ndarë midis pronarëve dhe përkatësisht ndërmjet F. Y., B. M. dhe V. N., ku pallati ***** njihet në pronësi të vëllait të bashkëshortit (B. M.). Fakti që gjatë periudhës së përdorimit nuk është paraqitur asnjë problem, tregon se midis pronarëve ka patur dakordësi për pronën.*

Kemi filluar të banojmë në 20 janar të vitit 2007, datë që e lidh me faktin se atë ditë ka ditëlindjen nëna ime. Duke qenë se jemi futur në një pallat ndërtim i ri, apartamenti ka qenë bosh. Ishin

porositur mobilje te punishtja e marangozit B. I., ishte bërë dhe pagesa pas marrjes së një kredie te 'Raiffeisen Bank', në dhjetor të vitit 2006 dhe pajisja është bërë pjesë-pjesë, sipas mundësisë së montimit të kushtëzuar nga rrethanat e kohës (ndërprerje e vazhdueshme e energjisë elektrike etj.). Ndërkohë jemi sistemuar me orenditë e disponuara përfshirë dhe disa elektroshtëpiake të blera, ndër vite, që i disponoj dhe aktualisht. Në kohën që jemi futur, kompleksi ka qenë thuajse i populluar. Na është thënë verbalisht të futemi në atë apartament dhe kontrata e huapërdorjes ndërmjet dy vëllezërve M. është formalizuar në ditët në vijim. Jam e hapur dhe e disponueshme në çdo kohë që apartamenti në përdorim dhe ai i blerë me kredi të verifikohen fizikisht.

Nuk kam pasur dijeni nëse kontrata e huapërdorjes së apartamentit është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pasi nuk kam pasur akses për të marrë informacion në regjistrin publik. Nenet 143, 144, 193 të Kodit Civil për regjistrimin e sendeve dhe të drejtave reale mbi to, përcaktojnë parime të përgjithshme të cilat më vonë specifikohen tek dispozitat që parashikojnë kontratat e veçanta. Neni 193 thotë se shitja e pasurisë së paluajtshme duhet të regjistrohet, por regjistrimi në fakt nuk i humbet vlefshmërinë kontratës, thjesht ka penalitet në zyrën e regjistrimit në bazë të nenit 25 të ligjit "Përk", nr. 111, viti 2018. Po ashtu, neni 193 i Kodit Civil thotë se të drejtat reale duhet të regjistrohen. Ky, gjithashtu, është parim i përgjithshëm, por në çdo rast duhet t'i referohemi kontratave të veçanta. Regjistrimi ka të bëjë me garancinë e palëve, me njohjen nga të tretët dhe publicitetin e veprimit juridik. Është parim i rëndësishëm juridik që kurrë një nen nuk lexohet i veçuar nga të tjerët. Neni është germë, por dhe në harmoni me nenet e tjera, në rastin tonë është huapërdorja, neni 901 e vijues i Kodit Civil nuk kërkon detyrimisht që kontrata të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet. Kontrata kur nuk ka afat, zgjidhet me kërkesën e palëve në çdo kohë. Në rastin tonë kontrata e lidhur midis palëve në kushtet që janë në marrëdhënie të afërta familjare, vëllezër, do të thotë që asnjëra prej tyre nuk ka pasur nevojë për garanci ligjore për zbatimin e kontratës. Kontrata zgjidhet automatikisht në çdo kohë dhe regjistrimi në hipotekë mund të bëhet në çdo kohë me kërkesë të palëve.

Një qëndrim të tillë kanë mbajtur dhe kolegjet e bashkuara në Gjykatën e Lartë me Vendimin Unifikues nr. ***, datë ***, në çështjen me palë paditës Gj. N, i paditur Z. N. me objekt detyrimin e lirim të një banese të blerë me kontratë. Kolegjet e Bashkuara shprehen se: ... regjistrimi nuk ka vlerë krijuese, në kuptimin që regjistrimi nuk është një element i perfeksionimit dhe as kusht për fitimin e të drejtës mbi pasurinë e paluajtshme. Regjistrimi nuk eliminon nulitetin apo pavlefshmërinë e kontratës si veprim juridik i regjistruar në regjistrin publik. Sistemi i regjistrimit nuk krijon të drejta, por është një sistem i publikimit deklarativ. Pra, regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është element i vlefshmërisë së tij (kontratës)".

3.18 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën *Vetting* përdorimin familjar të këtij apartamenti që prej vitit 2007. Po ashtu, në DPV-të që prej vitit 2007, rezulton se subjekti ka deklaruar këtë adresë banimi. Shpjegimet e subjektit lidhur me përdorimin e apartamentit, të ndërthurura me arredimin, si dhe pagimin e konsumimit të energjisë elektrike dhe ujit, krijojnë bindjen se deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting* janë të sakta dhe përputhen me faktet e ndodhura ndër vite.

3.19 Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se subjekti ka bërë deklaram të saktë në deklaratën *Vetting* dhe se bazuar në bindjen e brendshme nuk u gjetën elementë për të ngritur dyshime të tjera lidhur me këtë pasuri dhënë në përdorim të bashkëshortit të subjektit nga vëllai i tij e që mund ta vendos subjektin në ndonjë nga kushtet e nenit 33 pika 5 të ligjit nr.84/2016.

4. Mbi aktivitetin tregtar të shoqërisë "F.M." sh.p.k., me përfaqësues z. F.M.

4.1 Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratat periodike të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit në shoqërinë "F.M.", sh.p.k., me NIPT ****.

4.2 Komisioni i ka kërkuar subjektin që të paraqesë dokumentacionin e plotë ligjor (leje ndërtimi, situacion punimesh, burimi i të ardhurave për financimin e ndërtimit, të drejtat mbi ndërtimin e kryer nga kjo shoqëri dhe nëse ka realizuar kontrata porosie, premtim shitje apo çdo formë tjetër kalim të drejtash për ndërtimin ndaj palëve të treta).

4.3 Në kthim përgjigje të pyetësorit II, subjekti ka sqaruar se: *“Pas një periudhe 10-vjeçare në gjendje pasive, shoqëria “**** sh.p.k., me NIPT ****, ka riçelur aktivitetin në korrik të vitit 2005, me lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi me shtetasin G. D., administrator i firmës së ndërtimit “****” sh.p.k. Aktiviteti është çelur me qëllim ndërtimin e një shtese pallati ekzistues ****, në rr. “****” nga shoqëria “****” sh.p.k., me lejen e ndërtimit nr. **, datë 28.5.2004, ku shoqëria “****” sh.p.k., do të menaxhonte aktivitetin. Në kohën e riçeljes së aktivitetit punimet e shtesës kishin ngecur në soletën e katit të dytë. Bazuar pikës 6 të marrëveshjes, shoqëria “****” sh.p.k., do t’i siguronte mjetet financiare nëpërmjet një kredie që do të merrej nga “Banka Popullore” e cila nuk u aprovua.*

*Në pritje të aprovimit të kësaj kredie, i vetmi aktivitet i shoqërisë “****” sh.p.k, ishte një kontratë porosie me një individ për blerjen e dy ambienteve në objektin e ndërtuar me lejen nr. **, datë 28.5.2004, por dhe kjo u anulua me marrëveshjen e palëve për arsye personale të porositësit dhe shuma është rikthyer. Anulimi është bërë nga vetë porositësi (R. K.) në kohën e disbursimit të kredisë së marrë prej tij në shumën 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro në ish-NGB, për qëllime të kësaj kontrate. Për këto arsye dhe për shkak të mospërputhjes me ortakun i cili i ka parashtruar kërkesa të paligjshme për shtim katësh tej përcaktimeve në lejen e ndërtimit, aktiviteti nuk u zhvillua asnjëherë dhe shoqëria “****” sh.p.k., nuk krijoi të ardhura ...”.*

4.4 Subjekti ka bashkëlidhur në përgjigje të pyetësorit dokumentacion, si vijon:

- Leje Ndërtimi nr. **, datë 20.12.2004, në emër të subjektit ndërtues “I****” sh.p.k. (formulari nr. **), miratuar me vendim të KRRT-së nr. **, datë 28.5.2004, për objektin godinë banimi dhe shërbimi ** në rr. “****”, në favor të subjektit ndërtues në pronë të familjeve S., D., etj. (fragment nga planimetria e Tiranës).

- Kontratë Bashkëpunimi për Sipërmarrje Ndërtimi nr. ** rep., nr. ** kol., datë 7.7.2005, me palë F.M. si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e investitorit dhe G. D. administrator i shoqërisë ndërtimore “*****” sh.p.k.

****, me objekt ndërtimin e ndërtesës për shërbim dhe banim në një truall në rr. “****”.

- Kontratë Porosie nr. ** rep., nr. ** kol., datë 1.11.2006, ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., dhe shtetasit R.K. për dy apartamente në objektin në rr. “****”; mandatpagesë e shumës 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro nga NGB, shtetasit F. M. në datën 7.1.2007; mandatpagesë nr. **, datë 12.1.2007, shtetasit R.K. nga subjekti “****” sh.p.k; Deklaratë Noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 15.3.2016, me deklarues shtetasin R.K.J, me përmbajtje zgjidhjen e kontratës së porosisë dhe tërheqjen mbrapsht të shumës 99.000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro.

- Certifikatë Regjistrimi për TVSH me nr. serial **, lëshuar në datën 26.7.2005, nga DPT-ja me vulë të Degës Përmet në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., rr. “****”, Tiranë; kërkesa nr. ** prot., datë 12.1.2018; Formulari i Deklarimit dhe i Pagesës së TVSH, datë 11.1.2007, ku shoqëria “****” sh.p.k me NIPT *****nuk ka kryer aktivitet; Libri i Shitjeve dhe Libri i Blerjeve dhjetor 2006; vërtetim nr. ** prot., datë 15.6.2009, lëshuar nga Shërbimi i Statistikës pranë QSU-së “Nënë Tereza” Tiranë; kartela klinike nr. **, viti 2008; Certifikatë Çregjistrimi e subjektit “****”, me NIPT **.

4.5 Komisioni i ka kërkuar informacion¹⁵ Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në lidhje me pasqyrat financiare të paraqitura nga shoqëria “****” sh.p.k., dhe në shkresën kthim përgjigjeje¹⁶

¹⁵Shkresë nr. ** prot., datë 13.5.2020.

¹⁶Shkresë kthim-përgjigje nr. **, datë 5.6.2020, nga DRT-ja Gjirokastër.

DRT-ja Gjirokastër ka konfirmuar se për këtë subjekt nuk disponohen të dhëna tatimore në sistemin C@TS dhe në arkiv.

4.6 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar raportin e kontrollit,¹⁷ datë 16.5.2007, të ushtruar nga Dega e Tatim Taksave Përmet, mbi bazën e kontrollit të ushtruar sipas programit nr. *** prot., datë 2.5.2007, të miratuar nga kryetari i Degës Tatimeve, të firmosur nga z. F. M. dhe inspektori i tatimeve z. ****, nga ku ka rezultuar: “...subjekti “****” sh.p.k., sipas dokumentacionit në dosjen përkatëse dhe NIPT-it të marrë ushtron aktivitetin e tij në ndërtimin e një objekti për shërbime dhe banimi në rr. “****”, Tiranë, që nga gusht i vitit 2005 dhe në vazhdim...”.

Bilanci kontabël: “Bilanci së bashku me anekset përkatëse deklaratat e realizimit dhe derdhjes së tatim fitimit së bashku me dokumentacionin përkatës që kërkohej në zbatim të legjislacionit dhe udhëzimeve të DPT për vitin 2005 nuk janë dorëzuar në zyrat përkatëse të DTT Përmet. Nuk disponohen as librat e blerjes dhe shitjes dhe asnjë dokumentacion për objektin në ndërtim si situacione të tjera. Po kështu, deri më sot që kontrollohet nuk është dorëzuar bilanci për vitin 2006...”.

Kontrolli i subjektit në objektin e ndërtimit: “Në mungesë të dokumentacionit... u kontrollua gjendja faktike e veprimtarisë ekonomike të subjektit në lidhje me NIPT sekondar të marë dhe rezultoi se në këtë objekt ishin kryer punimet përkatëse. Objekti ndodhej në fazën e e ndërtimit të plotë konstruktiv dhe janë mbyllur e ndarë me tulla si dhe kryer suvatimet në pjesën më të madhe të tij. Pra, situata e ndërtimeve faktike ishte *** katet e para në ndërtim vetëm konstruksion kurse në *** katet e tjera ishin përfunduar, konstruksioni, ndarja e mbyllja me tulla dhe suvatimet përkatëse. Në momentin e kontrollit po punohej nga një grup punonjësish prej 3 veta në suvatimet. Në këto kushte subjektit ju kërkuan gjithë dokumentacioni i objektit që ndërtohej nga ana e tij dhe ai dispononte vetëm një kontratë bashkëpunimi me sipërmarrje në ndërtim, si dhe leja e ndërtimit nga Bashkia Tiranë të dhënë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. me të cilën ka një kontratë sipërmarrje. Ju kërkuan dokumentacioni në lidhje me punimet e kryera deri në dhjetor të vitit 2006 dhe nuk disponohej asnjë lloj si në lidhje me blerjet dhe punimet e kryera ashtu dhe me shitjet (situacionet e ndryshme mujore progresive”.

Vlerësimi i situatës tatimore: “Ndonëse leja e ndërtimit është marrë për *** kate nga ana jonë është bërë rivlerësimi për ndërtimet faktike të objektit me *** kate, ndonëse shitesat janë kryer pa leje ndërtimi...”.

4.7 Gjithashtu, Komisioni administroi procesverbalin¹⁸ e datës 11.5.2007, i mbajtur për shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***, firmosur nga z. F.M.dhe nga ku rezultoi:

4.7.1 Detajet e parregullsisë: “Nga kontrolli i dokumentacionit për vitin 2005-2006 rezulton se subjekti deri më sot nuk ka dorëzuar bilancet respektive dhe F.D.P sipas afateve ligjore...”

Sipërfaqja faktike që po ndërtohet si më lart, ndonëse ju kërkua dokumentacioni përkatës për ndërtimin e objektit dhe subjekti nuk i dispononte duke marrë dhe deklarimin e subjektit është 1,471 m²...”.

4.8 Komisioni administroi kontratën e sipërmarrjes të datës 1.11.2006, lidhur midis porositësit R.K. dhe shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k., me përfaqësues z. F.S.M. Kontrata ka objekt marrjen përsipër të sipërmarrësit të ndërtimit dhe shitjes në favor të z. R.K., dy apartamente kati i parë dhe kati i dytë me strukturë **** me sip. 125 m²/secili.

¹⁷ Dosja e ILDKPKI-së, f. ***.

¹⁸Procesverbal në dosjen e ILDKPKI-së, f. ****.

4.9 Në lidhje me çmimin është përcaktuar se porositësi do të blejë apartamentet e mësipërme kundrejt çmimit 900 euro/m² dhe në total në vlerën 225,000 euro: “Kjo shumë do të paguhet nga porositësi me këste të përcaktuara, si vijon:

*Sot në datën e lidhjes së kësaj kontrate nga porositësi z. R.K., është shuma prej 40,000 (dyzetë mijë) euro pagesë, e cila do të do të pasqyrohet në mandatpagesën e shumës 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro nga NGB, F.M., në datën 12.1.2007; mandatpagesë nr. ***, datë 12.1.2007, shtetasit R.K. nga subjekti “***” sh.p.k; deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol., datë 15.3.2016, me deklaruës R.K. me përmbajtje zgjidhjen e kontratës së porosisë dhe tërheqjen mbrapsht të shumës 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro”.*

4.10 Komisioni kërkoi informacion në “ABI Bank” (ish-NBG)¹⁹ në lidhje me transaksionet e kryera në llogari të personit të lidhur, z. F.M. dhe në kthim përgjigje²⁰ rezultoi se në datën 12.1.2007, në llogarinë individuale të subjektit është kryer një kreditim me transfertë të brendshme në shumën 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro me përshkrimin: “...blerje apartamenti nga R.K. kalim në favor të F.M. administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “*****” sh.p.k.,... ”.

4.11 Në kthim përgjigje të pyetësorit II, subjekti ka deklaruar që kjo kontratë është anuluar me marrëveshjen e palëve për arsye personale të porositësit dhe shuma është rikthyer. Anulimi është bërë nga vetë porositësi.

4.12 Nga sa më lart, duket se në kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.11.2016, me notere Xh.B., lidhur midis proshitës R.K. dhe shoqërisë sipërmarrëse “*****” sh.p.k., me përfaqësues z. F.S.M., citohet leja e ndërtimit, si vijon në nenin 1: “...me vendim nr. ***, datë 28.5.2004, KRRT- ja pranë Bashkisë Tiranë ka miratuar lejen për ndërtimin në emër të shoqërisë “*****” sh.p.k., duke përcaktuar edhe projektin për realizimin e këtij investimi godinë banimi dhe shërbimi *** në rr. ‘***, Tiranë... ”.

4.13 Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni në shkresën kthim përgjigjeje²¹ të ILDKPKI-së, leja e ndërtimit nr. ***, datë 20.12.2004, me vendim KRRT-së nr. ****, datë 28.5.2004, rezulton se i është dhënë subjektit ndërtues “*****” sh.p.k., dhe jo “*****” sh.p.k. Shoqëria “*****” sh.p.k., nuk është palë në këtë kontratë sipërmarrje me z. R.K..

4.14 Për shumën e dakordësuar, si kësti i parë prej 40,000 (dyzetë mijë) euro, që do të paguhej nga z. R.K. në favor të shoqërisë “*****” sh.p.k., nuk është paraqitur asnjë dokument provues për marrjen në dorëzim nga shoqëria e kësaj shume.

4.15 Shuma prej 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro e cila është kredituar në datën 12.1.2007, në llogari personale të z. F.M., në NBG, është transferuar nga z. R.K., për likuidimin pjesor të dy apartamenteve dhe është tërhequr *cash* brenda ditës nga F.M., por F.M. (individ) nuk është palë në kontratën e sipërmarrjes dhe, rrjedhimisht, fondet duhet të kalonin në llogari të shoqërisë që ka lidhur kontratën

4.16 Shuma prej 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro nuk është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në DPV-në e vitit 2007 dhe nuk është dhënë asnjë sqarim për përdorimin e kësaj shume

4.17 Mandatpagesa nr. ***, datë 12.1.2007, në shumën 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro, shtetasit R.K. nga subjekti “*****” sh.p.k., me përshkrimin: “Anulim kontrate porosie pallat *****”, e cila është kryer më 12.1.2007, në të njëjtën ditë me tërheqjen e kryer nga z. F.M. në llogarinë personale rezulton e kryer nga shoqëria “*****” sh.p.k., por përfitimi i kësaj shumë siç sqarohet më lart është kryer nga z. F.M. (individ).

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 14.10.2020.

²⁰Kthim-përgjigje me komunikim elektronik e-mail, datë 16.10.2020, ora *****, nga “ABI Bank”.

²¹Shkresë kërkesë për informacion nr. *****prot., datë 21.9.2020, dhe shkresa kthim-përgjigje nr. ***** prot., datë 12.10.2020, të ILDKPKI-së.

4.18 Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ****rep., nr. *** kol., datë 15.3.2016, me deklaruës shtetasin R.K., me përmbajtje zgjidhjen e kontratës së porosisë dhe tërheqjen mbrapsht të shumës 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro me mandatin nr. ***, datë 12.1.2007.

4.19 Kjo deklaratë ka një hapësirë kohore prej më shumë se 9 vjetësh nga kryerja e transaksioneve midis palëve dhe objekti nuk është për dy apartamente siç është përshkruar në kontratën e sipërmarrjes por për një dyqan dhe një apartament banimi.

4.20 Subjekti nuk ka paraqitur bilancet e shoqërisë “****” sh.p.k., për vitet 2005, 2006 dhe 2007, gjithashtu, edhe Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër²² sqaron se nuk disponohen të dhëna tatimore në sistemin C@TS dhe në arkiv.

4.21 Subjekti ka deklaruar se kontrata e bashkëpunimit për sipërmarrje ndërtimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.7.2005, me palë F.M. si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e investitorit dhe z. G.D. administrator i shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k., ndërtim “****”, me objekt ndërtimin e ndërtesës për shërbim dhe banim në një truall në rr. “****”, për shkak të mospërputhjes me ortakun i cili i ka parashtruar kërkesa të paligjshme për shtim katesh tej përcaktimeve në lejen e ndërtimit, aktiviteti nuk u zhvillua asnjëherë dhe shoqëria “F.M.” sh.p.k., nuk krijoi të ardhura.

4.22 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka vërejtur se nga raporti i kontrollit²³, datë 16.5.2007, të ushtruar nga Dega e Tatim Taksave Përmet, i cili është firmosur nga shtetasi F. M., në cilësinë e administratorit, ka rezultuar se : “...subjekti “****” sh.p.k., sipas dokumentacionit në dosjen përkatëse dhe NIPT-it të marrë ushtron aktivitetin e tij në ndërtimin e një objekti për shërbime dhe banimi në rr. “****”, Tiranë, që nga muaji gusht 2005 dhe në vazhdim... situata e ndërtimeve faktike ishte *** katet e para në ndërtim vetëm konstruksion kurse në *** katet e tjera ishin përfunduar, konstruksioni, ndarja e mbyllja me tulla dhe suvatimet përkatëse. Në momentin e kontrollit po punohej nga një grup punonjësish prej 3 veta në suvatimet. Në këto kushte subjektit ju kërkuan gjithë dokumentacioni I objektit që ndërtohej nga ana e tij dhe ai dispononte vetëm një kontratë bashkëpunimi me sipërmarrje në ndërtim si dhe leja e ndërtimit nga bashkia Tiranë (for 4) të dhënë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., me të cilën ka një kontratë sipërmarrje. Ju kërkuan dokumentacioni në lidhje me punimet e kryera deri në dhjetor 2006 dhe nuk disponohej asnjë lloj si në lidhje me blerjet dhe punimet e kryera ashtu dhe me shitjet (situacionet e ndryshme mujore progresive)”.

4.23 Nuk provohet cila është vlera e investimit dhe cili është burimi i të ardhurave që shoqëria me administrator dhe ortak të vetëm z. F.M. me të cilat është ndërtuar godina ****katëshe dhe më pas është lidhur kontrata e porosisë për shitjen e disa pasurive në këtë godinë.

4.24 Komisioni ka administruar shkresën e DPPPP-së²⁴ një transaksion të kryer nga z. F. M., në datën 4.5.2012, në shumën 700,420 (shtatëqind mijë e katërqind e njëzetë) lekë pranë NBG-së (tashmë “ABI Bank”), me përshkrimin “...derdhje...burimi i të ardhurave biznes...”. Komisioni ka kërkuar pranë “ABI Bank”²⁵ dokumentacionin për transaksionin në shumën 700,420 (shtatëqind mijë e katërqind e njëzetë) lekë depozitim cash të kryer nga personi i lidhur, z. F.M., dhe në përgjigjen me nr. *** prot., datë 10.11.2020, “ABI Bank” ka konfirmuar se ky transaksion është kryer nga personi i lidhur, z. F.M., në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k.

4.25 Janë kërkuar të dhënat nga ALUIZNI dhe ASHK për këtë ndërtim. Komisioni ka kërkuar në datën 23.10.2020²⁶, pranë “ABI Bank”, dosjen e plotë për shtetasin R.K. dhe në kthim

²² Shkresë kthim-përgjigje nr. ***, datë 5.6.2020, DRT-ja Gjirokastër.

²³ Dosja e ILDKPKI-së, f. ***.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 10.5.2017, në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 9.11.2020.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 23.10.2020.

përgjigjeje²⁷ nuk rezultojnë të dhëna shtesë në lidhje me marrëdhënien e palëve për porositjen dhe shitjen e dy apartamenteve .

4.26 Për sa më sipër duket se:

- i. Nga hetimi i Komisionit rezulton se shoqëria “***” sh.p.k. rezulton se ka kryer punime në këtë objekt nga gusht 2005 – maj 2007 dhe ka lidhur edhe kontrata sipërmarrjeje për shitje të pasurive në këtë godinë duke kryer edhe arkëtime në llogari personale.
- ii. Nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit, për këtë ndërtim, si dhe shpenzimet për këtë aktivitet.
- iii. Nuk provohen me dokumentacion ligjor provues deklaratimet e subjektit, për sa kohë pretendohet se kthimi i të ardhurave të marra nga z. R.K., iu kthye nga shoqëria, pa provuar se si u transferuan këto të ardhura nga administratori te shoqëria.
- iv. Subjekti duhet të paraqesë shpjegime lidhur me këtë transaksion të kryer nga personi i lidhur, z. F.M., në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k.

4.27 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

4.28 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me barrën e provës së lënë nga Komisioni, për aktivitetin tregtar të ushtruar nga bashkëshorti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Shoqëria “***” sh.p.k. me NIPT ****, nuk ka zhvilluar asnjëherë aktivitet për ndërtimin e objektit shtesë pallati *** në rr. “*****”, me lejen e ndërtimit nr. ***, datë 20.12.2004, me vendim të KRRT-së nr. ***, datë 28.5.2004, të nxjerrë në emër të subjektit ndërtues “**” sh.p.k., ndërtuar në fakt *** kate. Objekti është ndërtuar tërësisht nga shoqëria “**” sh.p.k., me administrator G. D.. Nga shoqëria “****” sh.p.k., nuk është bërë asnjë blerje materiali, nuk janë kryer pagesa etj., që lidhen me punime të kryera në objektin në rr. “****”, fakt që konfirmohet dhe nga dokumentacioni i mbajtur nga organet tatimore. Sipas raportit të kontrollit në datën 16.5.2007, të Degës së Tatim Taksave Përmet, nga ana e subjektit disponohej vetëm një kontratë bashkëpunimi me sipërmarrje në ndërtim, si dhe leja e ndërtimit nga Bashkia Tiranë (formulari nr. **) e dhënë në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. Në faqen e fundit të titulluar “Vlerësimi i situatës tatimore” thuhet se nga ana e subjektit nuk disponohej dhe nuk ishte kryer asnjë shitje deri në datën e kontrollit (Raport kontrolli i vitit 2007, f. ***, mbajtur nga Dega e Tatim Taksave Përmet).*

*Administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., z. G. D. është dhe personi që ka aplikuar në emër të tij në dhjetor të vitit 2006 për nxjerrjen e Lejes së Legalizimit, aplikim i bërë fshehtas bashkëshortit, i cili dijeninë e ka marrë rastësisht vite më vonë nga banorët e pallatit. Në lidhje me objektin është nxjerrë Leja e Legalizimit nr. ***, datë 12.6.2018, në favor të subjektit “****” sh.p.k., me përfaqësuese ligjore vajzën e G. D. (E. D.).*

*Vërtetimi nr. *** prot., datë 8.10.2020, i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, provon aplikimin e bërë në vitin 2006 nga G. D. për legalizimin e objektit dhe aplikimin e bërë në vitet 2014 dhe 2015 nga vajza e tij E. D. (nr. **** prot., datë 15.10.2020, e ASHK-së Tiranë, dorëzuar me përgjigjet e pyetësorit II, datë 14.10.2020).*

*Shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ****, nuk ka realizuar të ardhura dhe nuk ka kryer shpenzime, ndaj dhe nuk janë pasqyruar deklarime në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike.*

*Për sa i përket pasaktësisë në Kontratën e Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. **** kol., datë 1.11.2006, lidhur me lejen e ndërtimit që paraqitet si e nxjerrë në emër të shoqërisë së bashkëshortit, është*

²⁷Shkresë kthim-përgjigje nr. ****prot., datë 27.10.2020, nga “ABI Bank”.

*lapsus nga ana e noterës. Këtë e provon dhe fakti se bashkëlidhur kontratës së sipërmarrjes është dokumenti “Leje Ndërtimi” në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., me të njëjtat ekstremite si ato në kontratën e sipërmarrjes përveç emrit të subjektit që është nxjerrë (vendim nr. ***, datë 28.5.2004, i KRRT-së pranë Bashkisë Tiranë në emër të subjektit ndërtues “****” sh.p.k., formulari nr. 4).*

*Shuma 40,000 (dyzetë mijë) euro që përmendet në kontratë nuk është dorëzuar nga shtetasi R.K. Shuma 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro që përbën fondin e kredisë të tërhequr nga R.K., transferuar në datën 12.1.2007, në llogari personale të bashkëshortit dhe kthyer po atë ditë këtij personi, nuk u përdor asnjëherë në funksion të aktivitetit ndërtues. Ky fakt përkon dhe me përgjigjen në shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2020, të “Abi Bank” që përmend llogari rrjedhëse kredie në euro në datën 11.1.2007 (ish ***) *** me kredimarrës R.K. dhe bashkëkredimarrëse bashkëshorten e tij B. K..*

Pavarësisht se transferimi është bërë në llogari personale të bashkëshortit, qëllimi i shumës ka qenë për aktivitetin e shoqërisë dhe si e tillë ka qenë detyrim i tij për ta deklaruar në organet tatimore dhe jo në deklaratën si person i lidhur, pasi nuk është e ardhur apo shpenzim. Mandati për kthimin mbrapsht të shumës mbart vulën e shoqërisë së bashkëshortit.

*Lidhur me Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.3.2016, të bërë rreth 9 vjet më vonë nga R.K. shpjegohet me faktin se si bashkëshorte e z. F.M., në atë kohë erdha në dijeni kur jam pyetur në ILDKPKI. Pas informacionit të marrë në ish-NBG (dega tek ***) se anulimi i kontratës së sipërmarrjes ishte bërë de facto, i kërkova bashkëshortit që një deklaram i tillë të bëhej para noterit.*

*Në lidhje me shumën 700,420 (shtatëqind mijë e katërqind e njëzetë) lekë, të derdhur në datën 4.5.2012, në llogari të shoqërisë “*****” sh.p.k., është e pavërtetë që transaksioni është kryer nga bashkëshorti. Punonjësi i ish-NBG Bank, sot “Abi Bank”, ka hedhur të dhëna të jo të sakta në sistemin elektronik të bankës, për transaksionin nr. ****, datë 4.5.2012. Nga përgjigja e “Abi Bank”, datë 4.12.2020, dhe ballafaqimi me kopjen fizike të transaksionit të kryer me mandatin, datë 4.5.2012, rezulton se derdhja nuk është bërë nga bashkëshorti F.S.M., por nga F. S.M.. Sipas dhënave në QKB-së ky person, i panjohur prej nesh, është administrator i shoqërisë “*****” sh.p.k., me NIPT ****, themeluar në datën 13.4.2012.*

*Për të provuar shpjegimet lidhur me transaksionin në shumën 700,420 lekë ((shtatëqind mijë e katërqind e njëzetë), pranë “ABI Bank”, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: përgjigjen e “Abi Bank”, datë 4.12.2020; Ekstrakt nga QKB (të dhëna të printuara) të shoqërisë “*****” sh.p.k. me administrator F.M.”.*

4.29 Trupi gjykues i Komisionit krijoi bindjen se transaksioni i kryer në llogarinë personale të z. F.M. personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, është kryer për llogari të shoqërisë së ndërtimit. Nisur nga rrethanat e faktit dhe dokumentacioni i administruar në dosje, trupi gjykues, krijoi bindjen lidhur me veprimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit se qëllimi i këtij transaksioni është qartësuar dhe provuar me dokumentacionin e paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit, si rrjedhojë, është një veprim i kryer brenda vitit dhe që nuk ka sjellë të ardhura apo përfitime për subjektin e rivlerësimit apo personin e lidhur, të cilat duheshin deklaruar. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim sipas legjislacionit në fuqi për ta deklaruar këtë veprim në deklaratën *Vetting*.

4.30 Lidhur me veprimtarinë tregtare të personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit), trupi gjykues krijoi bindjen se ajo nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit dhe as me ushtrimin e detyrës së saj. Bashkëshorti i subjektit ka vepruar si tregtar në mënyrë të pavarur nga subjekti i rivlerësimit. Veprimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, të cilat, për më tepër, nuk kanë sjellë

as përfitime në ekonominë e përbashkët familjare, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e ndonjë mase disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit. Në këtë rast subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kushtet për ta konsideruar mosdeklarimin e transaksionit si fshehje të pasurisë, në kuptim të procesit të rivlerësimit, si dhe asnjë nga kushtet e tjera të parashikuara në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

5. Pikë karburanti në fshatin ***, Përmet

5.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën Vetting: “Pikë karburanti në fshatin ***, Përmet, (jofunksionale që nga ngjarjet e vitit 1997), krijuar në vitin 1994 me të ardhurat nga aktiviteti privat në vitet 1992 dhe 1993, vlera: 3,500,000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, pronë individuale e paregjistruar...”.

5.2 Në DPV-në e vitit 2003 personi i lidhur ka deklaruar: “Karburant i dëmtuar në ngjarjet e vitit 1997, jashtë shfrytëzimit, vlera: 3,500,000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, nga të ardhurat e aktivitetit tregtar në vitin 1992 - 1993. Sqarim: vlera e karburantit në momentin e krijimit ka qenë 3,500,000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë”.

5.3 Nga hetimi i Komisionit²⁸ ka rezultuar se ASHK-ja Përmet nuk konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie në emër të subjektit.

5.4 Komisioni administroi në dosjen e ILDKPKI-së dokumentacionin lidhur me këtë pasuri:

- Vendim²⁹ nr. ***, datë 2.8.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, me kërkesë shtetasin F.S.M., me objekt “njohje pronësie mbi një objekt pikë karburanti, ndodhur në ***”, në të cilin është vendosur: ...*pranimi i kërkesës. Vërtetimin e faktit të pronësisë së kërkuarit F.M.mbi një pikë karburanti të ndodhur në anë të rrugës automobilistike Përmet-Këlcyrë, afër fshatit ***, përbërë nga një godinë parafabrikate, mbuluar me llamarinë gjashtë çisterna dhe aparate furnizimi me karburant. Pika e karburantit kufizohet nga veriu me përrua, nga jugu me tokë arë, nga lindja me rrugë automobilistike, nga perëndimi me lumin Vjosa.*

- Vërtetim pronësie³⁰ datë 8.1.1996, me përmbajtje: ... *një pikë karburanti të ndodhur në anë të rrugës automobilistike Përmet-Këlcyrë, afër fshatit ***, përbërë nga një godinë parafabrikate mbuluar me llamarinë, gjashtë çisterna dhe aparate furnizimi me karburant. Pika e karburantit kufizohet nga veriu me përrua, nga jugu me tokë arë, nga lindja me rrugë automobilistike, nga perëndimi me lumin Vjosa...*

...*Pronësia është përfituar me vendim gjyqësor nr. ***, vendimi ***akt, datë 2.8.1994... Pronësia është regjistruar në regjistrat e transkriptimit të hipotekës Përmet, me nr. ***, datë 21.7.1995 në radhorin nr. ****të pronës...*

- Procesverbal Kolaudimi³¹ datë 6.12.1993 dhe Procesverbal nr. *** për punimet e kryera në ndërtimin e pikës së karburantit për një: *Pikë shitjeje karburant dhe lubrifikant në fshatin ***, në rrugën Përmet-Këlcyrë ... Afati i ndërtimit të objektit ishte prej datës 1.5.1993 – 25.11.1993... Shpenzimet totale arritën vlerën e situacionit prej 3,698,580 lekësh... Investitori eksport-import “****”; batuesi firma ****, kolaudatori ing. P.P.....*

- Kërkesë³² datë 20.12.1993, nga kërkuari F.M., drejtuar Këshillit të Rrethit Seksionit të Urbanistikës për leje shfrytëzimi “pikë shitje karburant”, mbështetur në ligjin nr. 7720, datë 14.6.1993, për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve.

- Licencë nr. ***³³, datë 12.1.1994, për shitjen me pakicë të karburanteve në emër të shtetasit F. S.M., Përmet.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2020, lëshuar nga zyra vendore, ASHK-ja Përmet.

²⁹ Vendim nr. ***, datë 2.8.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, me objekt “njohje pronësie pikë karburanti” f. ***, dosja e ILDKPKI-së.

³⁰ Vërtetim pronësie datë 8.1.1996, f. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

³¹ Procesverbal kolaudimi për pikë karburanti datë 6.12.1993, në f. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

³² Kërkesë datë 20.12.1993, në f. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

³³ Licenca nr. ****, datë 12.1.1994, në f. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

- Vendim nr. ***³⁴, datë 19.12.2000, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, me kërkues F. S. M., me objekt “vërtetim i faktit juridik që kufijtë e hipotekuar ndodhen në sipërfaqen 13,000 m², neni 388 i Kodit të Procedurës Civile”, në të cilin është vendosur: *Pranimi i padisë. Vërtetimi i faktit juridik se brenda kufijve të përcaktuar në vërtetimin e pronësisë së paditësit F.M. pranë Zyrës Hipotekore Përmet me nr. ***, në regjistrat e transkriptimit dhe nr. **** në radhorin e pronësisë ndodhet sipërfaqja prej 13,000 m² me kufizime: veriu – përrua; jugu – tokë arë; lindja – rrugë automobilistike; perëndimi – lumi Vjosa.*

5.5 Lidhur me regjistrimin, Komisioni administroi një korrespondencë elektronike³⁵ midis ILDKPKI-së dhe ZVRPP-së Përmet, në të cilën është konfirmuar se: *“Për pikën e karburantit ju bëjmë me dije se nuk ka të dhëna në azhurnimet e reja të zonës ku ndodhet ky objekt. Ekzistojnë të dhëna vetëm në regjistrat e vjetër hipotekorë, por nuk është bërë regjistrimi i tij në sistemin e ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Bashkëngjitur po ju dërgojmë një kopje të regjistrit vjetër hipotekor”.*

5.6 Komisioni administroi procesverbalin e mbajtur në datën 21.3.2016 nga ILDKPKI-ja, ku subjekti është kërkuar që të japë sqarime në lidhje me këtë biznes (burimi, dokumentacioni), për të cilat ka sqaruar se: *“... së pari, sqaroj se me aktivitetin privat të biznesit që ka pasur bashkëshorti im pas viteve 1990, si para martesës, edhe pas martesës, që daton në gusht 1994, unë nuk kam pasur lidhje dhe nuk jam përfshirë në asnjë drejtim. Gjithë dijenitë e mija për sa kam sqaruar më parë në ILDKPKI dhe për të gjitha ato që do të sqaroj sot, i kam ose si qytetare e thjeshtë e qytetit të Përmetit, ose nga sqarimet që më ka bërë vetë bashkëshorti, pasi jam thirrur nga ana juaj. Për sa i përket biznesit të bashkëshortit sqaroj se ai ka filluar aktivitetin e tij privat rreth viteve 1992 – 1993, fillimisht me kambizëm dhe me tregti të disa artikujve të ndryshëm ushqimorë apo industrialë në qytetin e Përmetit, pas këtij aktiviteti ndërtoi një pikë karburanti po në qytetin e Përmetit (në fshatin ***) në vitin 1993, aktiviteti i të cilit ka filluar në fillim të vitit 1994. Me sa kujtoj gjithashtu bashkëshorti im ka ushtruar edhe një aktivitet tjetër tregtar në fushën e tregtimit të cigares. Edhe ky aktivitet është ushtruar në rreth vitit 1993. Për sa i përket pikës së karburantit sqaroj se në vitet 1997 është dëmtuar edhe për shkak të ngjarjeve të vitit 1997. Në vitet 1994 - 1997 bashkëshorti im ka jetuar më tepër në Tiranë ku është marrë me aktivitetin e cigareve dhe në fund të vitit 1997 kam ardhur në Tiranë edhe unë dhe kam filluar punë në fund të vitit 1998 si Oficere e Policisë Gjyqësore Krujë. Në vitin 1998 e më tej bashkëshorti im ka punuar punë të ndryshme si rrogetar dhe nuk ka ushtruar aktivitet tregtar”.*

5.7 Komisioni i ka kërkuar³⁶ ILDKPKI-së dokumentacionin që ka paraqitur subjekti dhe me shkresën kthim përgjigjeje, datë 12.10.2020, nga ILDKPKI-ja rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga është i njëjti dokumentacion në dosjen e ILDKPKI-së, duke administruar si dokument shtesë vetëm aktin “procesverbal datë 29.5.1994” në degën e policisë financiare për kontrollin e aktivitetit të importit dhe tregtimit të karburanteve, i cili ka filluar në datën 10.2.1994, në të cilën janë konstatuar disa parregullsi dhe është vendosur masë administrative.

5.8 Komisioni, në pyetësin II, i ka kërkuar subjektit dokumentacion ligjor provues në mënyrë të qartë dhe kronologjike për pronësinë e kësaj pasurie, për dokumentacionin ligjor të ndërtimit (duke përfshirë leje ndërtimi dhe leje shfrytëzimi), si dhe për financimin e ndërtimit dhe burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave për investimin në këtë pasuri dhe pasqyrat financiare të njësuara me ato të paraqitura në institucionet kompetente, për këtë aktivitet për të gjithë kohën e kryerjes së veprimtarisë.

³⁴ Vendimi nr. *** dhe akti *** datë 19.12.2000, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, me objekt “vërtetim fakt juridik që kufijtë e hipotekuar ndodhen në sip. 13,000 m², neni 388 i Kodit të Procedurës Civile”.

³⁵ Korrespondenca datë 28.9.2018, midis ILDKPKI-së dhe ZVRPP-së Përmet.

³⁶ Shkresë nr. ***, datë 21.9.2020

5.9 Në lidhje me pronësinë e objektit, subjekti, në përgjigje të pyetësorit II, ka sqaruar se: “...Për objektin pikë karburanti në fshatin **** në vitin 1996 është bërë kërkesë për regjistrimin e kësaj prone, por për shkak të ngjarjeve të vitit 1997 transformimit të objektit në gjendje gjërmadhë dhe largimit familjarisht nga qyteti i Përmetit, procesi u ndërpre dhe nuk u ndoq më tej. Për këto arsye, dhe për shkaqe ekonomike, ende nuk disponojmë certifikatë për vërtetim pronësie...”

5.9.1 Subjekti paraqiti, në cilësinë e provës, leje ndërtimi nr. ***, lëshuar në prill të vitit 1993, nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Përmet për një pikë shitjeje karburanti, sipas parcelës me sip. 1,620 m², sipas projektit të projektuar nga ing. F.H. ing. K.Ç., zbatimi i punimeve nga firma ***, afati i punimeve brenda vitit 1993.

5.10 Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për financimin e investimit të ndërtimit subjekti ka paraqitur:

- Vërtetim datë 14.4.1993, nga “Banka Kombëtare Tregtare”, dega Përmet, me përmbajtje: “Vërtetohet se F.M., me llogari bankare nr. ****, ka garanci bankare për të financuar pikë karburanti në Përmet. Lëshohet ky vërtetim me kërkesën e të interesuarit...”

- Të ardhurat nga bizneset e mëparshme, bazuar në dokumentacion (konferma bankare) mbi veprime bankare të kryera nga bashkëshorti F.M. gjatë ushtrimit të aktivitetit në vitin 1993. - Huamarrje nga persona të ndryshëm, kryesisht rreth miqësor, shoqëror, fisnor etj., sipas kontratave të huadhënies.

- Pasqyrat financiare të ushtrimit të aktivitetit nga shoqëria “****” sh.p.k. në Përmet, për periudhën janar - dhjetor 1994, dorëzuar pranë Zyrës së Tatim-Taksave Përmet (njëzet e dy fletë formati me emërtimin e kohës “ditar/pasqyrë rezultati”, të njësuar).

- Bilancin me datë 31.3.1995, të dorëzuar në DTT-në Përmet, për gjendjen financiare të shoqërisë “*****” sh.p.k., për periudhën e ushtrimit të aktivitetit janar - dhjetor 1994; vërtetim me datë 2.4.1995, i lëshuar nga eksperti kontabël i pavarur R. K..

5.11 Komisioni administroi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, ku konstatoi se bilanci i vitit 1994, i paraqitur prej saj, është i njëjtë me bilancin e rezultuar nga hetimi i Komisionit me shkresën datë 5.6.2020, të DRT-së Gjirokastër³⁷, nga ku rezulton se viti financiar 1994 është raportuar me humbje në vlerën - 2,174,419 (dy milionë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

5.12 Subjekti, në lidhje me të ardhurat që janë gjeneruar nga ky aktivitet subjekti, në pyetësorin II, ka sqaruar se: “... në objektin pikë karburanti në fshatin **, gjatë vitit 1994 është ushtruar aktivitet tregtimi si pikë shitjeje karburant dhe lubrifikant nga shoqëria “*****” sh.p.k., me administrator dhe ortak të vetëm F. M., në atë kohë pa numër identifikues, NIPT, i cili referuar legjislacionit të kohës, nuk ka ekzistuar si nocion dhe ka dalë me një ligj të mëvonshëm. Numri identifikues i Personit të Tatueshëm, NIPTI ****, ka shoqëruar shoqërinë “****” sh.p.k., si të dhënë identifikuese për regjistrimin e saj në organet tatimore rreth viteve 2000 e në vazhdim. Prej vitit 1995 në objektin pikë karburanti nuk është ushtruar aktivitet ekonomik, pra, nuk është shfrytëzuar, sepse nuk ka qenë rentabël, ndërsa prej vitit 1997 dhe aktualisht është gjërmadhë...”

5.13 Në përfundim, për sa më sipër, duket se nuk provohet me dokumentacion ligjor provues pronësia e truallit mbi të cilën është ngritur kjo pikë karburanti dhe gjendja aktuale e kësaj prone. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

5.14 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti, ka shpjeguar se: “Në kohën e ndërtimit, vitin 1993, ende nuk kishte një ligj që të lejonte shitblerjen e tokës pronë shtetërore dhe ndërtimi në truallin pronë shtetë është kryer sipas ligjeve në fuqi me leje të ish-Komitetit Ekzekutiv të kohës. Shitblerja

³⁷ Kërkuar informacion nga Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 13.5.2020, dhe kthyer përgjigje me shkresën nr. **** prot., datë 5.6.2020.

e trojeve pronë shtetërore është lejuar vetëm me daljen e ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, pra, pasi objekti pikë karburanti ishte ndërtuar. Më pas, për shkak të ngjarjeve të vitit 1997, që e shndërruan objektin në gërmadhë, largimit familjarisht nga qyteti i Përmetit dhe kryesisht pamundësisë financiare, procesi për regjistrimin e pronës përfshirë dhe shitblerjen e truallit u ndërpre dhe nuk vazhdoi më tej. Aktualisht objekti është jofunksional dhe në të njëjtën gjendje gërmadhë.”

5.15 Në përfundim lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues u bind nga shpjegimet e subjektit, duke vlerësuar se deklarimi i saj në deklaratën *Vetting* është i saktë dhe se ajo arriti të provojë bindshëm për Komisionin lidhur me historikun dhe ligjshmërinë e kësaj prone.

6. Tokë arë me sip. 832 m² në fshatin *, Përmet**

6.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *“Tokë arë me sip. 832 m², fshati ***, Përmet, krijuar nga ndarja e tokës ish-anëtarëve të familjes bujqësore me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën” pronë individuale, regjistruar në ZVRPP-në Përmet në datën 22.7.2013, me nr. pasurie 132/3”.*

6.2 Në DPV-në e vitit 2013 subjekti apo personi i lidhur nuk e kanë deklaruar këtë pasuri. Në DPV-në e vitit 2014 personi i lidhur ka deklaruar: *“Tokë arë me sip. 832 m², në fshatin ** Përmet, pjesë takuese nga prona në bashkëpronësi të familjes me kryefamiljarin S.M., përfituar nga ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, ndarë/pjesëtuar me Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.7.2013, regjistruar në ZRPP-në Përmet në datën 22.7.2013... ”.*

6.3 Komisioni kërkoi informacion pranë ASHK-së Përmet, e cila, me shkresën kthim përgjigjeje³⁸ datë 1.6.2020, ka konfirmuar se: *...F.S.M. ka në pronësi pasurinë e llojit arë, me sip. 832m², nr. pasurie ****, z. k. ***, vol. ***, f. ***, fshati ***, Përmet.*

6.3 Komisioni administroi bashkëlidhur shkresën kthim përgjigjeje të ASHK-së Përmet³⁹: *...Kontratë Pjesëtimi Pasurie e Paluajtshme datë 4.7.2013... objekti i Kontratës Pjesëtim/Ndarje Pasurive të Paluajtshme... bashkëpronarët familjarë kanë rënë dakord që pasuritë që kanë në bashkëpronësi t'i ndajnë në këtë mënyrë... ...F.S.M. merr pasurinë e paluajtshme të llojit arë, me sip. totale 832 m², me nr. pasurie ****, z. k. ***, vol. ***, f. ***, adresa ***, Përmet ...*

6.4 Gjithashtu, Komisioni administroi bashkëlidhur përgjigjen e ASHK-së Përmet, Kartelën Tip të Pasurisë arë, me sip. 832 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, indeksi i hartës **** në ***, Përmet.

6.5 Për sa më sipër, duket se subjekti/personi i lidhur me subjektin nuk ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën e vitit 2013. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

6.6 Subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me tokën arë të përfituar me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën” të regjistruar në ZRPP-në Përmet në datën 22.7.2013, pas pjesëtimin me Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.7.2013, pohojmë se nuk është deklaruar në kohë nga bashkëshorti, për shkak harrese të shkaktuar nga problemet shëndetësore në vazhdimësi pas operacionit në kokë në vitin 2008, por dhe për shkak se nuk është personi që është marrë personalisht me procedurat dokumentare. Për nxjerrjen e certifikatave individuale për vërtetim pronësie, ka aplikuar kunati i bashkëshortit (burri i motrës Gj. T.) dhe deklarimi është bërë në vitin pasardhës pas administrimit nga ana jonë të dokumentacionit të pjesëtimin dhe Certifikatës për vërtetim pronësie”.*

³⁸ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.6.2020, e ASHK-së Përmet.

³⁹ Kontratë Pjesëtimi Pasurie e Paluajtshme nr. *** prot., nr. *** kol., datë 4.7.2013.

6.7 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti rivlerësimi ka deklaruar saktë këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, e se mosdeklarimi në DPV-në e vitit 2013 nuk është i qëllimshëm.

7. Huat e deklaruara nga personi i lidhur

7.1 Komisioni ka pyetur subjektin në pyetësoin II në lidhje me huat e marra nga shtetasi F.M. në vitet 1993 – 1994 dhe të deklaruara respektivisht në DPV-të e viteve 2003 dhe 2006, si dhe në deklaratën *Vetting*, në total në shumën 17,100,000 (shtatëmbëdhjetë milionë e njëqind mijë) lekë, për identitetin e huadhënësve, përdorimin e fondeve të marra hua, mënyrën e likuidimit të huave ndër vite, vlerën e mbartur të huas për secilin huadhënës në secilin vit, nëse ka pasur interesa të akumuluar të cilat nuk janë paguar dhe nëse palët huadhënëse të cilat nuk janë shlyer, kanë nisur procese ligjore në gjykatë ndaj subjektit, bashkëshortit apo ndaj shoqërive të zotëruara prej tij për kthimin e huave gjatë gjithë periudhës kohore.

7.2 Subjekti, në kthim përgjigjen e pyetësorit II, ka deklaruar se: *“Në rrethanat kur me ngjarjet e vitit 1997 një pjesë e dokumentacionit që ndodhej në ambientet e pikës karburantit në *** pas bastisjes së saj u zhduk, disponojmë vetëm një pjesë të kontratave të lidhura me huadhënës të ndryshëm... Fondet e marra hua janë përdorur në funksion të aktivitetit të shoqërisë deri në kohën që është ushtruar aktivitet, në dhjetor të vitit 1994, periudhë gjatë së cilës huadhënësit kanë përfutuar edhe interesa, fakt i verifikueshëm nga konfermat bankare. Në pranverën e vitit 1995 kur është krijuar pamundësi pagese, huadhënësit të cilët janë kryesisht lidhje fisnore, shoqërore, pune etj., janë thirrur nga bashkëshorti F.M. në hotel **** të qytetit Përmet dhe iu është bërë me dije situata financiare për pamundësinë objektive të kthimit të huas... Nuk i njoh personalisht huadhënësit, nuk kam pasur kontakte me ta dhe asnjë prej tyre nuk më është drejtuar për marrëdhënien e huas që ka pasur me bashkëshortin. Fakt është se pjesa më e konsiderueshme e kontratave të huas janë lidhur në periudhën kohore 1993 - 1994, pra, para martesës, gusht 1994... ...Huat dhe kredia e marrë janë përdorur për qëllime biznesi, duke mos shërbyer në krijimin e ndonjë aseti... ...Në dijeninë time, nuk ka pasur dhe nuk ka çështje gjyqësore civile të shqyrtuara apo në proces gjykimi kundër meje apo kundër bashkëshortit. Bashkëlidhur: Vërtetim datë 5.5.2003, i Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet; Vërtetim nr. *** prot., datë 5.5.2003, i Zyrës së Përmbarrimit Përmet; Vërtetim datë 22.4.2003, i Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore Përmet; Vërtetim datë 5.5.2003, i Degës së Tatim- Taksave Përmet. Borxhi mbetet në nivelin moral, pasi huadhënësit janë ndërgjegjësuar se ishin borxhe për qëllime biznesi dhe me falimentimin e shoqërisë në vitin 1995 nuk ekziston më mundësia materiale për kthimin e tyre... ...Për sa i përket fondit kredi të marrë në BKT, çështja është marrë në trajtim nga Agjencia e Trajtimit të Kredive Tiranë (ATK)...”*

7.3 Nga hetimi i Komisionit⁴⁰ ka rezultuar se ATK-ja ka konfirmuar: *Për shtetasin F.S.M., i datëlindjes 10.11.1961, me nr. personal ****, sqarojmë sa më poshtë: Në emër të F.S.M. rezultojnë tri kredi të transferuara nga ish-Banka e Kursimeve Përmet, nga të cilat njëra i është akorduar z. F.M. dhe dy të tjerat që i janë akorduar z. G.I., me Vendim nr. *** datë 29.3.2002, të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet është bërë zëvendësimi i debitorit G.I. me debitorin e ri F.S. M. Detyrimi aktual i debitorit F.S. M. për të trija kreditë është:*

Detyrim ligjor	Monedha	Kredia e I-rë	Kredia e II-të (ish-G.I.)	Kredia e III-të (ish-G.I.)	Totali
Principal	lekë	1,400,000	1,000,000	2,910,000	5,310,000
Interes	lekë	5,665,210	4,009,934	8,981,210	18,656,354
Shpenzime të pafalshme	lekë	24,000	3,500	4,300	31,800

⁴⁰ Shkresë kthim përgjigjeje nr. ***** prot., datë 18.5.2020.

Arkëtime	lekë	100,000	0	0	100,000
Total	lekë	6,989,210	5,013,434	11,895,510	23,898,154

7.4 Bazuar në VKM-në nr. 450, datë 16.6.2010, neni 1 (a), pika 1.1 dhe në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror nr. 33, datë 24.9.2010, kreu 1, debitorit i falen 100% të interesave të transferuara dhe interesat e llogaritura në ATK në rast të shlyerjes së menjëhershme të detyrimit janë:

Detyrimi në rast të shlyerjes së menjëhershme	Monedha	Kredia e I-rë	Kredia e II-të (ish-G.I.)	Kredia e III-të (ish-G.I.)	Totali
Principal	lekë	1,300,000	1,000,000	2,910,000	5,210,000
Shpenzime të pafalshme	lekë	24,000	3,500	4,300	31,800
Total	lekë	1,324,000	1,003,500	2,914,300	5,241,800

7.5 Për sa më sipër, duket se:

- i) shpjegimet e subjektit për huamarrjet, të cilat vijnë të jenë aktuale, si dhe gjendjen e tyre aktuale apo marrëveshjet e arritura me palët huadhënëse, nuk provohen me dokumentacion ligjor provues;
- ii) detyrimi i deklaruar nga personi i lidhur me subjektin në deklaratën *Vetting* në shumën 1,000,000 (një milion) lekë sipas huas së marrë në “Bankën Kombëtare Tregtare” nuk përputhet me informacionin e marrë nga ATK-ja;
- iii) personi i lidhur me subjektin nuk ka deklaruar detyrimet e marra përsipër nëpërmjet marrëdhënieve me zëvendësim debitori në shumën totale prej 3,917,800 (tre milionë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekësh.

7.6 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

7.7 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar: “Lidhur me huat e bashkëshortit të marra në vitet 1993 – 1994, sikurse kam shpjeguar, nuk kam pasur njohje me huadhënësit dhe asnjë lloj komunikimi personal. Në dijeninë time të prejardhur nga bashkëshorti huat janë përdorur për qëllimet e biznesit dhe huadhënësit kryesisht miqësi, shoqëri, krushqi me bashkëshortin, i kishin të ardhura nga puna në emigracion.

Nëse do të ekzistonte një ligj falimenti në kohën kur është dorëzuar nga bashkëshorti bilanci i vitit 1994, dhe pasi janë mbledhur prej tij huadhënësit tek hotel ****, Përmet, ku ka shpallur falimentin një çështje e tillë nuk do ishte sot në diskutim, për më tepër që edhe të tretë kanë detyrime ndaj tij të lindura gjithashtu nga marrëdhëniet e biznesit.

Në lidhje me detyrimin për kredinë e marrë në vitin 1994 në ish-BKT-në e kohës, masa e detyrimit 1,000,000 (një milion) lekë është deklaruar nga bashkëshorti pas zbritjes së shumave këst kredie të paguara në kohën e aktivitetit të para vitit 1995, sipas konfirmave bankare të disponuara prej tij, pasi ishte tërhequr nga fondi kredi vetëm shuma 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë, sikurse shprehet edhe në kontratë.

Për sa i përket detyrimeve në ATK në ngarkim të bashkëshortit për arsye zëvendësimi debitori, nuk është bërë një deklaram i tillë për shkak të padijenisë, për të cilin edhe vetë kemi ardhur në dijeni me vonesë. Pasi kemi mësuar se zëvendësimi është bërë mbi bazën e një vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, gjyqtarit A. Sh. në një proces gjyqësor të zhvilluar në vitin 2002 në mungesë të bashkëshortit, kemi pretendimet tona, pasi zëvendësimi lidhet për kredi të marra nga

paditësi G. B., rreth viteve '96, në kohën kur bashkëshorti nuk kryente asnjë aktivitet tregtar që t'i nevojitej përdorimi i fondeve kredi të marrë prej tij. Pasi të njihemi me dosjen civile dhe të mundësojmë dokumentacionin e plotë, do të ndjekim rrugët ligjore të rishikimit të vendimit civil”.

7.8 Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se marrëdhënia e bashkëshortit të subjektit lidhur me aktivitetin e tij tregtar nuk është objekt deklarimi, përveç pjesës së të ardhurave dhe detyrimeve personale që ai mbart, të cilat rezultojnë se janë deklaruar nga subjekti në mënyrë korrekte në deklaratën *Vetting*. Po ashtu, nga hetimi nuk ka rezultuar se këto veprimtari të bashkëshortit në marrëdhënien e tij me shoqërinë tregtare të jenë ndikuar nga subjekti i rivlerësimit, apo ajo dhe familja e saj të kenë përfitime ose lidhje të ndryshme interesi me to. Kjo marrëdhënie rezulton të jetë tërësisht objekt i veprimtarisë së një shoqërie tregtare dhe duhet t'i nënshtrohet legjislacionit përkatës, por nuk mund të lidhet me subjektin dhe procesin e saj të rivlerësimit dhe as mund të ndikojë në dhënien ndaj saj të ndonjë mase disiplinore. Në kuptim të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk plotëson asnjë nga kushtet e parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

8. Lidhur me shpenzimet e shkollimit të personit të lidhur, znj. D.M. (vajza e subjektit të rivlerësimit)

8.1 Në deklaratën *Vetting*, në seksionin e të dhënave konfidenciale, personi i lidhur, znj. D. M., ka deklaruar: *“Gjendje cash e depozituar në llogarinë personale bankare pranë bankës “Societe Generale”, Francë, për të mundësuar shpenzimet e jetesës gjatë periudhës së studimit shtator 2013 – maj 2016 në Francë. Burimi i të ardhurave është sponsorizimi prej xhaxhait, shtetasit B.S.M.. Shuma totale: 26,010 (njëzet e gjashtë mijë e dhjetë) euro”.*

8.2 Komisioni verifikoi deklaratimet periodike të subjektit dhe vajzës së saj ndër vite.

8.2.1 Në DPV-në e vitit 2013, në seksionin “të dhëna konfidenciale, shpenzimet e deklarueshme mbi 500,000 (pesëqind mijë) lekë”, subjekti dhe personi i lidhur, vajza e saj, nuk kanë kryer asnjë deklaram.

8.2.1.1 Në datën 30.7.2013, në llogarinë me nr. ***** në “Societe Generale Albania” të personit të lidhur, znj. D.M., është kryer një depozitim *cash* në shumën 7,500 (shtatë mijë e pesëqind) euro, me përshkrimin “B.M., derdhje *cash*”, të cilat janë tërhequr *cash* nga personi i lidhur, vajza e subjektit, në datën 28.8.2013.

8.2.1.2 Kjo shumë nuk është deklaruar nga subjekti apo personat e lidhur në DPV-në e viti 2013 si e ardhura në formë sponsorizimi dhe nuk provohet se kjo shumë ka pasur destinacion pagimin e studimeve të vajzës së subjektit, pasi është depozituar pa përshkrim dhe është tërhequr nga mbajtësja e llogarisë, duke mos u provuar në vijim se këto të ardhura janë transferuar prej saj në shtetin francez.

8.2.1.3 Bazuar në analizën e mësipërme ligjore, për sa deklarimi i subjektit dhe personit të lidhur në deklaratën *Vetting* nuk mbështetet nga deklarimi periodik, si dhe nuk ka asnjë dokumentacion financiar provues se kjo shumë është transferuar në vendin e studimeve apo ka shërbyer për sponsorizimin e këtyre studimeve, nuk është llogaritur se ka shërbyer si sponsorizim në analizën financiare të vitit 2013.

8.2.2 Në DPV-në e vitit 2014, në seksionin “të dhëna konfidenciale, shpenzimet e deklarueshme mbi 300,000 (treqind mijë) lekë”, subjekti dhe personi i lidhur, vajza e saj, nuk kanë kryer asnjë deklaram.

8.2.3 Në DPV-në e vitit 2015, në seksionin “të dhëna konfidenciale, shpenzimet e deklarueshme mbi 300,000 (treqind mijë) lekë, personi i lidhur, znj. D.M., ka kryer deklarim si më poshtë: *...kosto jetese për studime të larta në Francë, për vitin shkollor 2014 – 2015, sponsorizuar nga*

*xhaxhai B.M., administrator i “****” sh.p.k., me urdhërxhirim në datën 19.8.2014, shuma 8,000 (tetë mijë) euro...*

8.2.3.1 Ky deklaram gjën mbështetje në sa ka rezultuar nga informacioni bankar se në datën 19.8.2014, në llogarinë nr. ****, në “Societe Generale Albania” të personit të lidhur, znj. D. M., është kryer një kreditim në shumën 8,000 (tetë mijë) euro, me përshkrimin “**** sh.p.k., sponsorizim për shkollë”. Kjo shumë është transferuar brenda ditës në favor të znj. D.M., me përshkrimin “*Living cost during the studies*”.

8.2.3.2 Për sa më sipër, referuar deklaramit të bërë në vitin 2015, i cili duket se ka korrigjuar mosdeklaramin e bërë në vitin 2014, sipas deklaramit të personit të lidhur në vitin 2015, i cili shërben si provë në këtë proces, është marrë në konsideratë se shuma e transferuar në gusht të vitit 2014 është 8,000 (tetë mijë) euro, e cila ka shërbyer për sponsorizim në vitet 2014 - 2015.

8.2.3.3 Referuar muajve të shkollimit shtator 2014 - qershor 2015, shuma 8,000 (tetë mijë) euro është ndarë si sponsorizim për vitin 2014, në vlerën 3,765 (tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) euro dhe për vitin 2015 deri në qershor për vlerën 4,235 (katër mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) euro.

8.2.4 Në DPV-në e vitit 2016, në seksionin “të dhëna konfidenciale, shpenzimet e deklarameshme mbi 300,000 (treqind mijë) lekë”, personi i lidhur, znj. D.M., ka bërë deklaram: *Kosto jetese për studime të larta në Francë për vitin akademik 2015 – 2016, sponsorizuar nga xhaxhai B.M., administrator i “****” sh.p.k., shuma 10,500 (dhjetë mijë e pesëqind) euro.*

8.2.4.1 Ky deklaram nuk mbështetet në dokumentacionin financiar provues, sipas të cilit për vitin shkollor 2015 - 2016 rezulton e provuar nëpërmjet transfertave bankare vetëm vlera 6,000 (gjashtë mijë) euro si sponsorizim nga xhaxhai, si vijon:

- transfertë⁴¹ në shumën 3,000 (tre mijë) euro në datën 5.10.2015, nga “Societe Generale Albania”, të kryer nga “****” sh.p.k., me përshkrim “*Sponsorship of the school for the student D.M.*” në favor të znj. D.M. në nr. ***** pranë “Societe Generale” në Francë, me adresë Paris, Francë;
- transfertë⁴² në shumën 1,200 (një mijë e dyqind) euro në datën 14.4.2016, nga “Societe Generale Albania”, të kryer në nga “****” sh.p.k., me përshkrim “sponsorizim shkolle për studenten D.M.”, në favor të znj. D.M. në nr. **** pranë “Societe Generale”, me adresë Paris, Francë;
- transfertë⁴³ në shumën 1,800 (një mijë e tetëqind) euro në datën 29.4.2016, nga “Societe Generale Albania” të kryer nga “*****” sh.p.k., me përshkrim “*Sponsorship of the school for the student D.M.*”, në favor të znj. D.M. në nr. **** pranë “Societe Generale” me adresë Paris, Francë.

8.2.4.2 Referuar muajve të shkollimit shtator 2015 - qershor 2016, shuma 6,000 (gjashtë mijë) euro është ndarë si sponsorizim për muajt përkatës dhe, për rrjedhim, janë llogaritur si sponsorizime në katër muajt e fundit të vitit 2015 në vlerën 2,625 (dy mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) euro dhe për vitin 2016 deri në muajin qershor në vlerën 3,375 (tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) euro.

8.2.4.3 Në llogarinë nr. **** të personit të lidhur, znj. D.M., është kryer një depozitim *cash* në shumën 4,500 (katër mijë e pesëqind) euro, datë 8.9.2015, me përshkrimin “D.M., të ardhura nga kursimet”.

⁴¹ Sipas konfirmimit bankar në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

⁴² Sipas konfirmimit bankar në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

⁴³ Sipas konfirmimit bankar në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

8.2.4.4 Kjo shumë është transferuar⁴⁴ brenda datës 8.9.2015, në favor të llogarisë së depozitueses D. M. me përshkrimin “*Living cost during the studies*”, në numrin e saj të llogarisë ****pranë “Societe Generale” në Francë.

8.2.4.5 Në dosjen e ILDKPKI-së, në mandatin e depozitimit të mësipërm në shumën 4,500 (katër mijë e pesëqind) euro, datë 8.9.2015, shënimi me shkrim dore “*sponsorizim për shkollën e mbesës time D.M. nga të ardhurat e mia financiare... B.M.*”, nuk ka vlerë ligjore provuese, për sa nuk është në përputhje me legjislacionin bankar për identifikimin e klientit të bankës dhe për sa paratë janë depozituar *cash* nga vajza e subjektit, nuk ka asnjë dokumentacion ligjor apo financiar me vlerë provuese, i cili mund të vërë në dyshim pronësinë e këtyre likuiditeteve nga depozituesja, vajza e subjektit. Kjo e fundit nuk ka deklaruar si burim në derdhjen *cash* të bërë prej saj sponsorizimin nga xhaxhai, duke deklaruar vetëm se këto janë të ardhura nga kursimet.

8.2.4.6 Këto të ardhura janë llogaritur në analizën financiare si të mbuluara nga subjekti i rivlerësimit.

8.3 Komisioni i kërkoi subjektit⁴⁵ në datën 23.10.2020 të depozitojë dokumentacion ligjor provues për burimin e ligjshëm të krijimit për shumat e deklaruara të sponsorizuara nga shtetasi B. M. për shkollimin e vajzës në Paris për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

8.4 Komisioni administroi vërtetimin e datës 27.10.2020 (jo noterial) të paraqitur nga subjekti⁴⁶ me përmbajtje “*Vërtetim... me të cilin vërtetohet se kam paguar për mbesën time D.M. shpenzime shkollimore për vitet 2013 - 2017 shumën 28,300 (njëzet e tetë mijë e treqind) euro... kjo shumë ka qenë kontributi im për shkollimin e mbesës time dhe nuk kam asnjë pretendim për kthimin e saj mbrapsht... B.M.*”.

8.5 Deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* dhe deklarimi në deklaratën noteriale të sponsorizuesit referojnë se sponsorizimet janë bërë nga xhaxhai i vajzës së saj, prandaj dhe duhet të sillet dokumentacion ligjor provues mbi të ardhurat e përfituara gjatë viteve si individ nga shtetasi B.M..

8.5.1 Në këtë këndvështrim, vlerë provuese për të ardhurat e individit ka dokumentacioni i mëposhtëm:

- Deklaratë dividendi e vitit 2014 dhe deklaratë individuale vjetore e të ardhurave (DIVA 2014)⁴⁷ të shtetasit B.M. në të cilën janë deklaruar për vitin 2014 të ardhura *bruto* nga paga, shuma 2,160,000 (dy milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të ardhura *bruto* nga dividendi, shuma 15,000,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë dhe të ardhura *bruto* nga qiraja, shuma 1,668,000 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë.

- Kontratë Qiraje nr. **** rep., nr. **** kol., datë 25.11.2011, me palë B.M. dhe qiramarrësit **** sh.p.k., për një dyqan me sip. 160 m², të ndodhur në Tiranë, të regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë në pronësi të qiradhënësit. Qiraja është përcaktuar në shumën 1,000 euro/muaj, për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data 1.11.2011 – 1.11.2016.

8.6 Për të shpjeguar arsyet përse nuk janë deklaruar shumat e sponsorizimeve sipas parashikimeve ligjore në fuqi për deklarimin e pasurive në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014, subjekti, në kthim përgjigje, ka sqaruar: “*Kam filluar të deklaroj rregullisht në ILDKPKI prej vitit 2004 dhe nga kjo kohë deri në vitin 2012 nuk kam pasur detyrim për të deklaruar shpenzime. Me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” me ligjin nr. 85/2012 ku për herë të parë*

⁴⁴ Sipas konfirmimit bankar në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

⁴⁵ Korrespondenca elektronike datë 23.10.2020, ora ****.

⁴⁶ Korrespondenca elektronike datë 29.10.2020, ora ****.

⁴⁷ Bashkëlidhur në shkresën kthim përgjigje të subjektit në format elektronik. Korrespondenca elektronike datë 29.10.2020, ora ***.

u përfshi termi “shpenzim i deklarueshëm”, jam gjendur e papërgatitur dhe e papërshtatur me formatin e ri të formularit të deklarimit, si dhe me moskuptim të drejtë të termit ligjor “pagesë për arsim”, por vërtetohet në mënyrë të pakundërshtueshme kohën e shumave sponsorizuese dhe burimin e tyre...

Pagesat për vitet shkollore 2013 dhe 2014 janë kryer nga xhaxhai i vajzës, z. B.M., ndërmjet llogarive të tij ose llogarive të biznesit, vërtetuar kjo me derdhjen në datën 30.7.2013 të shumës 7,500 (shtatë mijë e pesëqind) euro, me urdhërues B.M. dhe xhirimin e brendshëm në datën 19.8.2014 të shumës 8,000 (tetë mijë) euro nga “****” sh.p.k. Këtë fakt e mbështes gjithashtu edhe me pagesat e kryera në vijim kronologjik për dy vitet e tjera shkollore 2015 dhe 2016.”

8.7 Lidhur me dy deklaratat periodike vjetore të paraqitura nga subjekti⁴⁸, në cilësinë e provës, Komisioni konstaton se Deklarata e vitit 2013 nuk është e njëjtë me atë të dorëzuar nga institucioni përgjegjës, ILDKPKI-ja, së bashku me deklaratat e tjera të periudhës 2003 - 2016 për subjektin dhe personat e lidhur. Në këtë kuptim, kjo provë nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni. Ndërsa, DPV-ja e vitit 2015 u mor në konsideratë nga Komisioni, për sa është administruar edhe nga dosja e ILDKPKI-së.

8.8 Për sa më lart, duket se:

- i) subjekti nuk ka arritur të shpjegojë se kush ka qenë sponsorizuesi i studimeve në këto vlera, shoqëria “****” sh.p.k., apo shtetasi B.M.;
- ii) lidhur me sponsorizimet e kryera nga shoqëria “****” sh.p.k. për shkollimin e vajzës, subjekti duhet të shpjegojë dhe të provojë me dokumentacion nëse shoqëria ka miratuar me vendim asambleje sponsorizimet;
- iii) subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues për pagesën e tatimit mbi qiranë me Kontratën nr. *** rep., nr. **** kol., datë 25.11.2011.

8.9 Subjekti, në lidhje me konstatimet e Komisionit, ka paraqitur këto shpjegime: “Në lidhje me deklaratimet e vajzës D.M., si person i lidhur, për vitin akademik të studimeve 2013 - 2014, i qëndroj shpjegimeve që kam dhënë më parë në ILDKPKI (procesverbali datë 21.3.2016). Deklarata periodike për vitin akademik 2013 - 2014 është dërguar prej saj nga Franca nëpërmjet shërbimit postar në datën 29.3.2014, në përputhje me korrespondencën personale midis meje dhe vajzës me e-mail në datën 11.3.2014 (bashkëlidhur dokumentacioni “e-mail Lindita Male – D.M., datë 11.3.2014) mbi udhëzimet për të plotësuar dhe dërguar dokumentacionin e deklaratës, i cili është dorëzuar prej meje në ILDKPKI sipas këshillimit të bërë nga punonjësi i ILDKPKI-së për të ecur me vit akademik dhe jo kalendarik. Në mars të vitit 2015 është dorëzuar fillimisht origjinali “autorizim për kontrollin e deklaratës së interesave private” (f. ***), pasi më është thënë në ILDKPKI se “kjo faqe mjafton nëse vajza nuk ka pasuri veçmas”, ndërsa faqet origjinale nr. 9, 10, 11 të deklaratës janë dorëzuar në mars të vitit 2016 tek punonjësi i ILDKPKI-së, E. D., së bashku me zarfin origjinal të dërgesës postare nga Franca. Nuk kam asnjë kontestim nëse deklarata periodike i nënshtrohet ekspertimit grafik të shkrimit dhe nënshkrimit që ka plotësuar këtë dokument. Mospërkimi viziv i fotokopjes i faqes nr. *** “autorizim për kontrollin e deklaratës së interesave private”, dorëzuar në mars të vitit 2016 në ILDKPKI bashkë me faqet origjinale nr. ****, të deklaratës periodike të vajzës, me origjinalin e “autorizim për kontrollin e deklaratës së interesave private”, të dorëzuar në ILDKPKI në mars të vitit 2015, është ngatërresë si rrjedhojë e rrethanave në vijim. Shpjegoj se deri në atë kohë nga vajza D.M. ishin plotësuar tre formularë deklarimi si person i lidhur, të cilat të gjitha janë pa datë, ndërkohë që në kohën e dorëzimit të fotokopjes së autorizimit vajza nuk ndodhej në Shqipëri. Gjithashtu, afati i lejuar për dorëzimin e materialeve mbështetëse të deklarimit të bërë në 21 mars 2016 në ILDKPKI ka qenë shumë i

⁴⁸ Bashkëlidhur në shkresën kthim përgjigje korrespondenca elektronike datë 29.10.2020, ora ****

kufizuar në kohë, vetëm disa ditë në të cilat janë përgatitur dhe dorëzuar rreth 70 materiale dokumentacion. Si rrjedhojë, shpjegoj se faqja nr. *** e plotësuar në vitin 2014, dorëzuar origjinali në vitin 2015, është vendosur gabimisht mbi dokumentacionin origjinal të deklaratës faqet nr. ****, të dorëzuar në vitin 2016. E kam korrigjuar këtë gabim, duke dorëzuar fotokopjen e saktë dhe të plotë të “deklaratës së interesave privatë të personit të lidhur” D.M., për studimet e viteve 2013 – 2014, dërguar me e-mail në datën 29.10.2020 si përgjigje e kërkesave të parashtruara në e-mail-in datë 23.10.2020.

Gjithashtu shpjegoj se pas njoftimit të pranimit për kryerjen e studimeve të larta në universitetin publik “****” në muajin qershor 2013, vajza nisi procedurat e aplikimit për vizë studentore afatgjatë (Visa de Long Sejour) pranë Ambasadës Franceze në Tiranë, për të mundësuar qëndrimin e saj në Francë përgjatë vitit akademik shtator 2013 – qershor 2014. Dokumentacioni i kërkuar prej Ambasadës Franceze (bashkëlidhur dokumentacioni “kërkesë për dokumentacion Ambasada Franceze, dok. të tjerë”) specifikon se për të aplikuar për këtë lloj vizë vajza duhet të dorëzonte një vërtetim bankar që të provonte gjendje të shumës minimale prej 615 (gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) euro në muaj për 12 muaj, pra, të gjithë periudhën vjetore të vitit të studimeve. Xhaxhai i vajzës, B.M., si sponsorizues i vitit të parë akademik, ka kryer depozitimin cash nga të ardhurat e kursimeve të tij në llogarinë e vajzës në “Societe Generale Albania” me mandatin datë 30.7.2013, së pari për të garantuar shumën e kërkuar nga Ambasada Franceze për vizën dhe së dyti për t’u përdorur gjatë studimeve në vitin e parë akademik. Me lëshimin e vërtetimit bankar, po më datë 30.7.2013 (bashkëlidhur dokumentacioni “vërtetim Societe Generale Albania 30.7.2013”) mbi gjendjen e shumës prej 7,500 (shtatë mijë e pesëqind) euro në përputhje me kërkesat e Ambasadës Franceze është dorëzuar “page ***” dokumentacioni i aplikimit për vizë, e cila u aprovua dhe u lëshua si dokumentacion në datën 7.8.2013 (bashkëlidhur dokumentacioni “Viza Franceze ***D.M. 2013”). Duke qenë se vajza nuk dispononte llogari bankare në Francë, pasi ishte hera e parë që shkonte atje, kjo shumë është tërhequr cash prej saj të mërkurën në datën 28.8.2013, vetëm disa ditë para udhëtimit të kryer ditën e hënë në datën 2.9.2013, vetëm dhe e pashoqëruar, në të cilin vajza ka marrë me vete të gjithë shumën e tërhequr për ta depozituar në llogarinë që do të hapte në një bankë franceze. Kjo shumë është depozituar pjesërisht prej vajzës në llogarinë personale të saj në bankën “Societe Generale” në Francë në muajin shtator 2013 (bashkëlidhur dokumentacioni “hapje llogarie dhe depozitim datë 4.9.2013 në Societe Generale France”). Në atë periudhë vajza, e cila ishte e vetme dhe papërvojë, më ka shpjeguar se depozitimin e bëri të pjesshëm pasi punonjësi i bankës, referuar dhe moshës së saj 18 vjeç, i ka shpjeguar se nuk mund të depozitonte shuma mbi 5,000 (pesë mijë) euro në mënyrë të menjëhershme dhe pa paraqitur një dokument të përkthyer zyrtarisht në frëngjisht për burimin e fondeve që do të depozitoheshin.

Nuk kam pasur arsye për të mos lejuar vajzën të pranojë financimin dhe as të dyshoj për ligjshmërinë e financimit nga xhaxhai, pasi ka një biznes të ligjshëm, të suksesshëm dhe pa probleme me institucionet ligjzbatuese. Ky person, si individ, apo edhe shoqëria që ka në administrim, nuk ka qenë subjekt apo objekt i ndonjë veprimtarie të paligjshme. Shoqëria “****” sh.p.k. operon prej shumë vitesh në tregun e ndërtimit dhe rezulton me fitim, sikurse vërtetojnë bilancet financiare të katër viteve apo dividendi i viti 2014 që janë dorëzuar nga ana jonë. Në mbështetje të këtij dokumentacioni bashkëlidh edhe dokumentacionin në vijim: “dividendi B. M. 2013” dhe “pagesa e tatimit në burim B.M.”, ku sqarohet se për pagesat e tatimit detyrimi ligjor është i qiradhënësit, por pagesat janë kryer nga qiramarrësi “****” sh.p.k., biznes i cili në mirëkuptim për këtë hetim dhe si palë e jashtme në të ka vënë në dispozicion dokumentacionin që disponon. Theksoj se financimi i studimeve të vajzës ka qenë me vullnetin dhe dëshirën e tij për ta mbështetur, pasi në të kundërt, në pamundësitë e mia financiare nuk do ta kisha dërguar. Nuk është bërë më parë deklaratë noteriale, pasi është marrëdhënie gjaku dhe nuk është konsideruar e

nevojshme nga ana jonë. Financimi është deklaruar rregullisht nga vetë vajza si person i lidhur. Xhaxhai e konfirmon sponsorizimin edhe me Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.12.2020, të lëshuar prej tij për efekt të këtij hetimi. Nuk kam pasur shkak dhe arsye ligjore për të mos pranuar sponsorizimin, pasi bëhet fjalë për marrëdhënie gjaku xhaxha-mbesë. Nuk jam në dijeni se për çfarë arsye paratë njëherë janë dhënë cash dhe herë të tjera nga llogaria e shoqërisë “***” sh.p.k, apo nëse vendimi i asamblesë për financimin është regjistruar në regjistrin e veçantë të shoqërisë, pasi nuk kemi pasur akses.

Në lidhje me regjistrimin e vendimit të financimit në regjistrin e shoqërisë, si ortak i vetëm (bashkëlidhur dokumentacioni “ekstrakt QKR, *** ndër vite”) dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., që ushtron njëkohësisht të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme, neni 81 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” përcakton se mosregjistrimi i vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë tregtare është absolutisht i pavlefshëm. Por në këtë rast, pra, kur nuk janë ndjekur procedurat konform ligjit brenda shoqërisë tregtare, përjashtohet nga përgjegjësia i treti përfitues. Kjo pasi pasojat juridike të ardhura tek i treti në mirëbesim, në këtë rast përfitues i financimit mbrohet nga parimi i mbrojtjes së palëve të treta. Pra, edhe nëse vendimi nuk është regjistruar në regjistrin, përfitimi i të tretit nuk është i jashtëligjshëm ose në keqbesim, pasi janë veprimet e ortakut të vetëm administrator të cilat passjellin përgjegjësi administrative apo civile lidhur me tejkalimin e tagrave në dhënien e një vlerë nga shoqëria tek individi.

Në vlerësimin tuaj, mund ta thërrisni për të dhënë deklarime vetë.”

8.10 Subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, dokumentet e sipërcituara në shpjegime.

8.11 Për shpenzimet e kryera për periudhën e qëndrimit të personit të lidhur, znj. D.M., në Paris, Francë, për periudhën shtator 2013 – dhjetor 2016 (ushqim, strehim, transport, etj.), në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se: “... për secilin vit akademik të studimeve universitare (10 muaj, shtator - qershor) janë kryer shpenzime jetese (ushqim, strehim, transport, etj.), përkatësisht:

- viti 2013 (shtator - dhjetor), në shumën 3,000 (tre mijë) euro;
- viti 2014 (janar - dhjetor), në shumën 7,900 (shtatë mijë e nëntëqind) euro;
- viti 2015 (janar - dhjetor), në shumën 9,300 (nëntë mijë e treqind) euro;
- viti 2016 (janar - dhjetor), në shumën 10,500 (dhjetë mijë e pesëqind) euro.

... D. M. për vitet akademike 2013 – 2017 ka ndjekur arsimin e lartë Bachelor në universitetin publik “****”, me adresë: ****, **** Paris, Francë...”

8.12 Në lidhje me qëndrimin në Francë të personit të lidhur, znj. D.M., subjekti ka deklaruar në pyetësorin standard: “Tri banesa kronologjikisht me adresat si më poshtë:

- dhomë me qira brenda banesës së ****, përgjatë vitit të parë akademik 2013 – 2014, 42 **** Paris, Francë;
- apartament me qira, përgjatë fillimit të vitit të dytë akademik, përkatësisht në datat 1.9.2014 – 1.3.2015, **** Francë;
- dhomë konvikti me qira, përgjatë mbarimit të vitit të dytë akademik, nga data 1.3.2015 deri në mbyllje të studimeve universitare në datën 1.7.2017, **** Paris, Francë”.

Qira, viti 2013

8.14 Nga sistemi TIMS rezultoi se personi i lidhur ka qëndruar jashtë vendit për periudhën 2.9.2013 – 31.5.2014. Në përgjigje të pyetësorit II subjekti ka sqaruar se: “...përgjatë vitit akademik shtator 2013 - maj 2014 fëmija D.M. ka banuar në apartamentin në pronësi të bashkëshortëve B. S. dhe F. S., me adresë: **** Paris, Francë. Në këtë apartament D.ka paguar për shfrytëzimin me qira

të një dhome me mëngjesin e përfshirë kundrejt tarifës 600 (gjashtëqind) euro, e cila është paguar me çek bankar (dokumentacioni bashkëlidhur ku evidentohen të gjitha pagesat e kryera në drejtim të znj. S. me çek bankar), si dhe ka kryer pagesa me vlerë 150-200 (njëqind e pesëdhjetë deri në dyqind) euro në muaj të ndryshëm, të cilat i shtoheshin vlerës së qirasë për shpenzime të ndryshme ekstra në këtë banesë sipas rastit (konsum i vakteve të drekës apo darkës me pronarët e shtëpisë). Kontrata e qirasë ka humbur gjatë zhvendosjeve në adresa të ndryshme dhe znj. S. ka ndërruar jetë në dhjetor të vitit 2014, prandaj ka pamundësi objektive për të siguruar kopje të kontratës... ”.

8.13 Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur në pyetësonin II kundraçeqet e pagesës së qirasë (jo në formën e kërkuar nga ligji) në favor të qiradhënëses F.S.. Shpenzimet vetëm për pagesën e qirasë për vitin 2013, për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion, rezultojnë të paguara në shumën 3,433 (tre mijë e katërqind e tridhjetë e tre) euro. Me dokumentacionin ligjor provues nuk provohet që këto vlera të kenë të përfshirë edhe ushqimin. Shpenzimet e qirasë për vitin 2013 u përllogaritën nga Komisioni në analizën financiare në shumën 3,433 (tre mijë e katërqind e tridhjetë e tre) euro, me rezervën se duhet të sillet dokumentacioni në formën e kërkuar ligjore.

8.14 Përllogaritja e shpenzimeve të strehimit në Paris për vitet e shkollimit për personin e lidhur, znj. D.M., është bërë me rezervë edhe për gjithë dokumentacionin tjetër provues, duke i kërkuar subjektit të paraqesë në formën e kërkuar nga ligji dokumentacionin sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

8.15 Nëse subjekti nuk do të paraqesë dokumentacion ligjor provues, Komisioni rezervon të drejtën t’i referohet kostove të qirasë dhe shpenzimeve publikuar në faqen e universitetit përkatës.

Qira, viti 2014

8.16 Nga sistemi *TIMS* rezultoi se personi i lidhur ka qëndruar jashtë vendit nga 1.1.2014 – 31.5.2014 (periudhë në të cilën ka deklaruar se ka banuar në apartamentin në pronësi të bashkëshortëve B.S.dhe F.S.) dhe për periudhën tjetër nga 1.9.2014 – 31.12.2014, subjekti, në pyetësonin II, ka deklaruar se: “...ka banuar në apartamentin me adresë: ***** **, Francë në pronësi të bashkëshortëve P.K. dhe C.E.K., me të cilët është lidhur Kontratë 1-vjeçare qiraje me vlerë mujore 820 (tetëqind e njëzetë) euro, ku 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) euro janë vlerë qiraje dhe 70 (shtatëdhjetë) euro janë shërbime të detyrueshme të mirëmbajtjes së godinës. Në këtë kontratë ka qenë bashkëqiramarrëse E.H., me të cilën D. ka ndarë përgjysmë vlerën e qirasë, duke paguar 410 (katërqind e dhjetë) euro në muaj... ..Pagesa e qirasë është kryer parapagim për 7 (shtatë) muaj (shtator 2014 – mars 2015) e evidentuar në dokumentin e faturës së qirasë “*Quitance de Loyer*” për të gjithë periudhën... ”.

8.17 Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur në pyetësonin II një Kontratë Qiraje (jo në formën e kërkuar ligjore), në të cilën duket se qiradhënësi P. K. dhe znj. C.K. kanë dhënë me qira një ambient me sip. 19.67 m² për një afat 1-vjeçar, në çmimin 750 euro/muaj dhe shpenzime mirëmbajtje 70 euro/muaj ndaj personit të lidhur, znj. D.M.dhe znj. E.H.

8.18 Në total, qiraja për të gjithë vitin 2014, në të dyja adresat e deklaruara nga subjekti, është paguar në shumën 5,850 (pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) euro dhe këto shpenzime u përllogaritën nga Komisioni në analizën financiare për vitin 2014.

Qira, viti 2015

8.19 Nga sistemi *TIMS* rezultoi se personi i lidhur ka qëndruar jashtë vendit për periudhat 1.1.2015 – 12.5.2015⁴⁹ dhe 12.9.2015 – 31.12.2015.

⁴⁹ Përveç 6 ditëve që është kthyer në Shqipëri për pushime, data 15.1.2015 – 21.1.2015 nga sistemi *TIMS*.

8.16.1 Subjekti, në pyetësonin II, ka deklaruar se: “...*gjatë mbarimit të vitit të dytë akademik mars 2015 dhe deri në mbylljen përfundimtare të studimeve universitare, korrik 2017, D. ka banuar në dhomën me qira të konviktit “*****” me adresë: *****, Paris, Francë, ku tarifa e qirasë mujore ka qenë 655 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) euro në muaj, me vaktin e mëngjesit të përfshirë, evidentuar në faturat e lëshuara nga konvikti siç paraqitet në dokumentacionin bashkëlidhur “*****. D.M.” për të gjithë periudhën...”.*

8.20 Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur me pyetësonin II një dokument tip “*Attestation d’hebergement*” (vërtetim akomodimi) nga institucioni që merret me strehimin e studentëve ***** (jo në formën e kërkuar ligjore), në të cilën konfirmohet se personi i lidhur, znj. D.M., është pranuar në këtë institucion dhe duke filluar nga shtatori i vitit 2015 do të jetë rezidente për vitin shkollor 2015 – 2016.

8.21 Subjekti ka bashkëlidhur me pyetësonin II edhe faturat e pagesës për qiranë pranë ***** për periudhën prill 2015 – 2016. Në total, qiraja për periudhën prill – dhjetor 2015 është paguar në shumën 3,320 (tre mijë e treqind e njëzet) euro dhe këto shpenzime u përlllogaritën nga Komisioni në analizën financiare për vitin 2015.

8.22 Për vitin 2015 shpenzimet e vitit janë deklaruar nga subjekti në shumën 9,300 (nëntë mijë e treqind) euro dhe janë konsideruar nga Komisioni sipas deklarimit të subjektit.

Qira, viti 2016

8.22 Nga sistemi *TIMS* rezultoi se personi i lidhur ka qëndruar jashtë vendit për periudhat 12.9.2015 – 17.5.2016, 14.6.2016 – 3.7.2016 dhe 8.9.2016 – 31.12.2016.

8.24 Subjekti ka bashkëlidhur me pyetësonin II edhe faturat e pagesës për qiranë pranë ***** për periudhën prill 2015 - 2016.

8.25 Në total, qiraja për periudhën janar – dhjetor 2016 është paguar në shumën 6,422 (gjashtë mijë e katërqind e njëzet e dy) euro dhe këto shpenzime u përlllogaritën nga Komisioni në analizën financiare për vitin 2016.

Shpenzimet për transport brenda Parisit

8.26 Komisioni ka pyetur subjektin në pyetësonin II në lidhje me shpenzimet e transportit në Paris për periudhën që personi i lidhur, znj. D.M., ka kryer studimet, e cila, në kthim përgjigje të pyetësonit ka sqaruar se: “...*shpenzimet e transportit ishin vjetore, duke kryer abonimin studentor me kompaninë ***** në vlerën 300-400 (treqind deri në katërqind euro) në muaj, sipas dokumentacionit provues më poshtë (vërtetime të lëshuara nga kompania me kryerjen e abonimit)...”.*

8.27 Subjekti ka bashkëlidhur në përgjigje të pyetësonit II abonetë për periudhat 2013 – 2016 (jo në formën e kërkuar ligjore), të cilat paraqiten si më poshtë në formë tabelare:

Viti	Çmimi i abonësë në euro
2013	323
2014	403
2015	333
2016	297

8.28 Këto shpenzime për transportin u përlllogaritën në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni, sipas deklarimeve të subjektit dhe aboneve të sipërcituara.

8.29 Shpenzimet për jetesë (ushqimi), të personit të lidhur, vajzës së subjektit, gjatë viteve 2013 – 2016 në Paris, u përlogaritën nga Komisioni sipas informacionit⁵⁰ për kostot mujore mesatare të shpenzimeve ushqimore në këtë universitet në Paris, për një student ndërkombëtar.

8.30 Nga informacioni i marrë sa më sipër, Komisioni përlogariti shpenzimet jetike ushqimore për periudhën e qëndrimit në Paris, të cilat janë, si vijon: viti 2013, në shumën 1,391 (një mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) euro; viti 2014, në shumën 3,490 (tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë) euro; viti 2015, në shumën 3,433 euro; viti 2016 në shumën 3,885 (tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) euro.

8.31 Lidhur me shpenzimet për tarifën e universitetit shtetëror në Paris, Francë⁵¹, të personit të lidhur, znj. D.M., në periudhën shtator 2013 - dhjetor 2016, subjekti ka deklaruar në pyetësonin standard: “...për studimet universitare janë kryer vetëm shpenzimet për regjistrimin në shkollë, konkretisht pagesa e taksës vjetore të regjistrimit ku përfshihet dhe siguracioni shëndetësor i detyrueshëm:

- viti akademik shtator 2013 – qershor 2014, pagesa në vlerën 399.10 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë dhjetë) euro;
- viti akademik shtator 2014 – qershor 2015, pagesa në vlerën 402.10 (katërqind e dy pikë dhjetë) euro;
- viti akademik shtator 2015 – qershor 2016, pagesa në vlerën 404.10 (katërqind e katër pikë dhjetë) euro;
- viti akademik shtator 2016 – qershor 2017, pagesa në vlerën 404.10 (katërqind e katër pikë dhjetë) euro”.

8.32 Komisioni i kërkoi subjektit në pyetësonin II të paraqesë dokumentacion justifikues për shpenzimet e regjistrimit në universitet në Paris për personin e lidhur, znj. D.M., e cila në kthim përgjigje të pyetësonit ka paraqitur (jo në formën e kërkuar ligjore):

- certifikatë nr. ***, e viteve 2013 - 2014, për studenten D.M., pagesa në vlerën 399.10 (treqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë dhjetë) euro;
- certifikatë nr. ***, e viteve 2014 - 2015, për studenten D.M., pagesa në vlerën 402.10 (katërqind e dy pikë dhjetë) euro;
- certifikatë nr. ****, e viteve 2015 - 2016, për studenten D.M., pagesa në vlerën 404.10 (katërqind e katër pikë dhjetë) euro;
- certifikatë nr. ***, e viteve 2016 - 2017, për studenten D.M., pagesa në vlerën 404.10 (katërqind e katër pikë dhjetë) euro.

8.33 Këto shpenzime për tarifën e regjistrimit u përlogaritën në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni sipas deklarimeve të subjektit dhe certifikatave të sipërcituara.

8.34 Komisioni përgatiti analizën financiare për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, si vijon:

	2013	2014	2015	2016
PASURI	1,142	92,319	-91,206	-4,650
Ndryshim likuiditeti	1,142	92,319	-91,206	-4,650
TOTAL LIKUIDITETE, DEKLARUAR	3,731	96,050	4,844	194
DETYRIME	0	0	400,000	1,000,000

⁵⁰ https://www.***.net/en/681/paris_1_panth_on_sorbonne_universityshpenzime 483 USD / muaj.

⁵¹ http://www.***.fr/inscription/frais-dinscription

Kredi në "Credins Bank", shuma 400,000 lekë, datë 7.9.2015 – 2.10.2016			400,000	
Kredi në "Credins Bank", shuma 500,000 lekë, datë 2.10.2016 – 2.12.2017				500,000
Kredi në "Credins Bank", shuma 500,000 lekë, datë 3.10.2016 – 3.10.2020				500,000
PASURI NETO	1,142	92,319	-491,206	-1,004,650
TË ARDHURA	1,091,616	1,805,959	2,169,082	1,696,489
Sponsorizim nga xhaxhai B.M.		527,473	944,319	456,536
Të ardhura nga bursa e shkollës M.M.		12,000	3,000	
Të ardhura nga paga Lindita Male (Ziguri)	1,091,616	1,266,486	1,221,763	1,239,953
SHPENZIME	1,884,108	2,779,435	2,850,996	3,169,784
Shpenzime për pagesë të huas ndaj personit tjetër të lidhur (daja) A.Gj.	140,210	140,110	137,650	
Shpenzime për takse vjetore regjistrimi në universitet në Francë për D. M.	55,958	56,338	55,624	54,663
Shpenzime për qiranë/transport dhe ushqime në universitet në Francë për D.M.	721,759	1,365,138	1,280,145	1,434,470
Shpenzime për këstin e kredisë për shtëpinë në "ABI Bank" (ish-NBG)	400,019	395,110	367,526	361,036
Shpenzime për këstin e kredisë, kredia 400,000 lekë në "Credins Bank", disbursuar më 7.9.2015			114,060	304,160
Shpenzime për këstin e kredisë, kredia 500,000 lekë në "Credins Bank", disbursuar më 2.9.2016				105,345
Shpenzime për këstin e kredisë, kredia 500,000 lekë në "Credins Bank", disbursuar më 3.10.2016				23,714
Shpenzime udhëtimi	49,074	107,745	148,405	113,492
Shpenzime jetese në Shqipëri	517,088	714,994	747,587	772,905
Analiza dokumentuar	-793,634	-1,065,795	-190,708	-468,645

8.35 Nga sa më lart, duket se subjekti ka qenë në pamundësi financiare, përkatësisht: viti 2013 me balancë negative në shumën 793,634 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) lekë; viti 2014 me balancë negative në shumën 1,065,795 (një milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind nëntëdhjetë e pesë) lekë; viti 2015 me balancë negative në shumën 190,708 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë; si dhe viti 2016 me balancë negative në shumën 468,645 (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) lekë.

8.36 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

8.37 Në lidhje me këtë situatë negative financiare, subjekti rivlerësimi ka shpjeguar në prapësime se e kundërshton atë, për sa i përket bilancit negativ për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, duke dhënë arsyetim dhe shpjegime në tërësi për analizën financiare të Komisionit, e cila trajtohet në pikën 9 të këtij vendimi.

ANALIZA FINANCIARE

9. Komisioni përgatiti analizën financiare të viteve 2003 – 2016, nga ku duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare, përkatësisht: në vitin 2005 në shumën -145,589 (njëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë; në vitin 2008 në shumën -1,006,828 (një milion e gjashtë mijë e tetëqind e njëzet e tetë) lekë; në vitin 2012 në shumën -89,588 (tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë; në vitin 2013 në shumën -793,634 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) lekë; në vitin 2014 në shumën -1,065,795 (një milion e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë; në vitin 2015 në shumën -190,708 (njëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë; si dhe në vitin 2016 në shumën -468,645 (katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) lekë. Në total për periudhën 2003 – 2016 balanca negative në shumën -3,760,786 (tre milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

9.1 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

9.2 Subjekti, në prapësimet e saj, ka shpjeguar lidhur me analizën financiare, duke e kundërshtuar atë dhe duke parashtruar sa vijon: “Klasifikimi statistikor që më është bërë për shpenzimet e jetesës nuk i përgjigjet nivelit real të jetesës në kushtet kur të ardhur kam pasur vetëm pagën time.

*Për vitin 2005, para, por edhe pas tij për vitet në vijim, nuk kam kryer shpenzime tej atyre të domosdoshmeve. Nuk kam disponuar asnjëherë makinë dhe nevojat e transportit i kam plotësuar me mjete të transportit publik. Nuk kam kryer asnjëherë pushime jashtë shtetit, madje me raste edhe brenda vendit. Për dy fëmijët është kujdesur gjithmonë gjyshja e tyre, nëna ime. Ushqimet e domosdoshme dhe ato bazike nisur nga vendbanimet e mia *** dhe “***” si zona jo preferenciale për banim, i përgjigjen çmimeve karakteristike të këtyre zonave, pra, çmime më të ulëta se zonat e tjera. Formula e përdorur për bilancin tim familjar nuk i përgjigjet realitetit faktik, pasi shpenzimet gjithmonë kanë qenë rreth minimumit dhe në përputhje me mundësitë e kufizuara financiare si familje me të ardhura vetëm pagën ime. Në vitin 2005, kur vendbanimi im ka qenë në **** dhe dy fëmijët e mi kanë qenë me moshë 4 dhe 10 vjeç, shpenzimet e tyre nuk mund të llogariten baraz me shpenzimet për një të rritur. Fakt është se fundi i vitit 2005, data 31.12.2005, më ka gjetur me gjendje të llogarisë së pagës në bankë në shumën 341,333 (treqind e dyzet e një mijë lekë, vlerë që korrespondon me mbetje nga pagat të pashpenzuara plotësisht (përgjigjja nr. 10255/1 prot., datë 22.5.2020, e “Raiffeisen Bank”, (vërtetimi), dërguar mbi kërkesën tuaj).*

*Për sa i përket bilancit të vitit 2008, kur është blerë edhe banesa ****, nëse do të llogaritet gjendja ime kursim e cila ka qenë në llogarinë time të pagës në vitin 31.12.2006 tërhequr gjatë vitit 2007, kursime të tjera deri në prill të vitit 2008, si dhe shuma hua 5,000 (pesë mijë) euro hua e marrë nga daja im (e cila në fakt është llogaritur nga ana juaj në shpenzime, bilanci familjar do të ishte pozitiv.*

*Të njëjtin shpjegim kam dhe për vitet e tjera, por kryesisht për sa i përket shpenzimeve të ushqimit gjatë studimeve me kohë të plotë të vajzës në Francë. Duke qenë se mundësia për të kryer studimet në Francë është e kushtëzuar çdo vit nga institucione zyrtare të shtetit francez përgjegjëse për lëshimin e vizës dhe lejes për qëndrim për vitet në vijim, vajza i është përmbajtur informacionit dhe kërkesës zyrtare të këtyre institucioneve për të garantuar për të gjithë periudhën e qëndrimit në çdo vit akademik shumën minimale prej 615 (gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) euro në muaj për të mbuluar të gjitha shpenzimet e jetesës. Për referencë në faqen zyrtare në anglisht dhe variantin origjinal në frëngjisht të faqes zyrtare në internet të Administratës Publike Franceze, përkatësisht tek rubrika “After 1 year of stay; Parts to supply” specifikohet se minimumi jetik që duhet garantuar financiarisht për një student të huaj në Francë është 615 (gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) euro në muaj (https://*****.fr/particuliers/vosdroits/F2231?lang=en). Si rrjedhojë, nuk mund*

të llogariten shpenzimet e ushqimit, ndarë nga shpenzimet e tjera të deklaruara prej vajzës si person i lidhur dhe të dokumentuara prej nesh, duke u bazuar vetëm në informacionin subjektiv të kompanisë private ruse, ****, e cila në kushtet e përdorimit të faqes së saj ëbsite është vetëpërgjashuar nga çdo përgjegjësi ligjore, për sa i përket saktësisë dhe vërtetësisë së informacionit në të (tarifat e universiteteve, kostot e jetesës në vendet ku ndodhen universitetet, etj.), pasi kompania i referohet në marrjen e këtij informacioni kontributeve nga opinionet e përdoruesve të çfarëdoshëm të faqes (bashkëlidhur dokumentacioni “Terms of Use UniPage”. Pranojmë referencat e bëra në faqen e universitetit përkatës (http://www.****.fr.inscription/frais-dinscription), për sa i përket tarifës së regjistrimit në shkollë e cila edhe aktualisht është e njëjtë me ato në dokumentacionin që ju kemi dorëzuar.

Në të gjithë periudhën e kryerjes së studimeve duhen konsideruar të gjitha shpenzimet e evidentuara me dokumentacion provues (bashkëlidhur në formën e kërkuar ligjore “dokumentacion D.M., Francë”) të vëna në raport me të ardhurat e mbështetura në dokumentacion provues (bashkëlidhur “Deklarata Noteriale B.M.” si dhe dokumentacioni i dorëzuar më parë për Kreditë Bankare të marra prej meje në shtator dhe tetor të vitit 2016 pranë “Credins Bank”, të bashkuara në një kredi të vetme në janar të vitit 2017 pas blerjes së tyre nga ABI Bank). Në përgjigjet e pyetësorit shtesë, dorëzuar në datën 21.5.2020, shuma totale e shpenzimeve të kryera në periudhën shtator 2013 – dhjetor 2016 është 30,700 (tridhjetë e shtatë mijë) euro, nga të cilat të dokumentuara për pagesa qiraje (përfshirë ushqimin në vitin akademik 2013 - 2014), pagesa të aboneve vjetore të transportit, pagesa të tarifës së regjistrimit në shkollë dhe pagesa të biletave të fluturimit (bashkëlidhur “bileta udhëtimi D.M.” pa përfshirë në dokumentacion, por e përfshirë në llogaritje biletën e fluturimit të parë drejt Parisit në datën 2.9.2013), rezulton shuma 23,905.16 (njëzetë e tre mijë e nëntëqind e pesë e gjashtëmbëdhjetë centimë) euro. Diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të dokumentuara për periudhën shtator 2013 – dhjetor 2016 rezulton në vlerën 6,794.84 (gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër e tetëdhjetë e katër centimë) euro dhe është shpenzuar për ushqim ndër vite. E mesatarizuar vetëm për efekt përlllogaritje, rezulton se në 31 muaj kohë qëndrimi të periudhës së analizuar shpenzimi jetik ushqimor ka qenë rreth 219 (dyqind e nëntëmbëdhjetë) euro në muaj. Por gjithashtu duhen marrë parasysh rrethanat faktike të kontekstit kohor dhe të jetesës ndër vite për këto shpenzime jetike ushqimore, ku shpjegoj se:

- Për vitin e parë akademik 2013 – 2014 vajza ka qenë e strehuar brenda të njëjtës banesë me znj. F.S., e cila i ka ofruar mundësinë e të ngrënit së bashku me një kosto variabël nga muaji në muaj (150-200 (njëqind e pesëdhjetë deri në dyqind euro) euro) dhe është fakt i njohur që pagesa e qirasë mujore për kohë të caktuar sipas legjislacionit civil është një shumë fikse, ndërsa dokumentacioni i dorëzuar prej nesh paraqet shuma variabël pagese me çek mbi 600 (gjashtëqind) euro, ku që të gjitha drejt një adresimi. Theksoj se në rezultatet e hetimit rezulton e paguar qira e vitit 2013 në vlerën 3,433 (tre mijë e katërqind e tridhjetë e tre) euro, por kjo vlerë është përlllogaritur gabim pasi merr në konsideratë çekun nr.1 (pagesa e abonesë vjetore ****, që është përlllogaritur edhe këtu dhe tek shpenzime transporti) si dhe çekun nr.5 (pagesë siguracioni i detyruar shëndetësor) që nuk janë të adresuar tek znj. S.. Nisur nga fakti se në dhjetor të vitit 2014 qiradhënësja, e ndjera F., ka ndërruar jetë, nuk mund të siguroj objektivisht kopje fizike Kontratës së Qirasë të lidhur me të (bashkëlidhur “komunikim me F.S.”, ku evidentohet komunikimi pas kthimit të vajzës në Shqipëri dhe status publik në rrjetin social Facebook bërë post-mortem nga familjarë të saj mbi faktin e vdekjes). Sqaroj se për këtë vit akademik vajza ka pasur në dispozicion shumën 7,500 (shtatë mijë e pesëqind) euro dhe të gjitha shpenzimet jetike (qira, ushqim, transport, bileta, etj.) janë kryer brenda kësaj shume.

- Për vitin e dytë akademik 2014 - 2015, fillimisht vajza ka qenë bashkëqiramarrëse me E. H. në apartamentin e P.dhe C. K.i dhe nga muaji prill 2015 e deri në mbyllje të studimeve ka qëndruar në konviktin ****. Në periudhën e bashkëqiramarrjes vajza ka qenë në jetesë të përbashkët me E. H., prandaj kostot e ushqimit pas shpenzimeve për qiranë, transportin, tarifën e shkollës të dokumentuara (bashkëlidhur “dokumentacion D. M., Francë”) rezultojnë të mesatarizuara në vlerën 150-200 (njëqind e pesëdhjetë deri në dyqind) euro. Theksoj se në rezultatet e hetimit për vlerën e qirasë së vitit 2014, vlera prej 5,850 (pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) euro është përlllogaritur gabim pasi shuma e çeqeve të paguara tek znj. S. në periudhën janar - maj 2014 është në vlerën 2,980 (dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) euro dhe shuma e pagesave paguar tek P.e K. (faturat e qirasë – Quittance de Loyer) për periudhën shtator - dhjetor 2014 është 1,640 (një mijë e gjashtëqind e dyzetë) euro, pra, në total 4,620 (katër mijë e gjashtëqind e njëzet) euro. Sqarohet se për vitin e dytë akademik vajza ka pasur në dispozicion shumën 8,000 (tetë mijë) euro dhe të gjitha shpenzimet jetike (qira, ushqim, transport, bileta, etj.) janë kryer brenda kësaj shume.

Për sa i përket ditëve të vizitës time në Francë nga data 26 tetor 2014 – 1 nëntor 2014, kam qëndruar tek vajza dhe jo në hotel, sepse vetë vizita ka qenë për këtë qëllim dhe jo për turizëm. Vajza rrinte në banesë me shoqe shqiptare, sikurse del dhe nga kontrata e qirasë që ju kemi dorëzuar dhe në mikpritje ka të njëjtat koncepte si çdo shqiptar që nuk mund të më orientonin hotelin për qëndrim. Gjithashtu, jam e paqartë si janë llogaritur shpenzimet përgjatë viteve të studimit shtator 2013 - 2016, ku sipas tabelës vërehet se përfshihet si frymë edhe në Shqipëri dhe në Francë.

Thënë sa më sipër, shpenzimet jetike për të gjithë periudhën e studimeve të Denadës kanë qenë në përputhje me limitet financiare minimale. Nëse në llogaritjen tuaj do të konsiderohen shpenzimet reale dhe faktike, bilanci i këtyre viteve do të rezultojë pozitiv”.

9.3 Lidhur me analizën financiare, subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, Aktin e Ekspertimit Kontabël datë 18.12.2020, ku bazon kundërshtimet sa më sipër, si dhe aktet e sipërcituara, të cilat u administruan nga Komisioni.

9.4 Në vlerësim të provave të paraqitura, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë prapësimeve mbi rezultatet e hetimit dhe në seancën dëgjimore, trupi gjykues krijoi bindjen se studimet e vajzës D. M. janë financuar nga xhaxhai i saj, i cili ka pasur të gjitha mundësitë financiare për të përballuar shpenzimet e shkollimit për mbesën e tij, dhe po ashtu edhe vullnetin për ta kryer këtë financim. Mospërputhja mes deklarimeve vjetore të subjektit dhe deklaratës *Vetting* lidhur me vlerën e financimit u konsiderua nga trupi gjykues si një pasaktësi në DPV, e cila ishte saktësuar dhe qartësuar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe për të cilën subjekti dha shpjegime të plota dhe të vërteta gjatë seancës dëgjimore.

9.5 Lidhur me situatën negative financiare, trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit, si dhe dokumentacionin ligjor provues të paraqitur prej saj në vijim të rezultateve të hetimit, arrin në konkluzionin se situata negative financiare në vitin 2008 ndryshon, pasi ajo arriti të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit (dajës së saj), por nuk pranoi shpjegimet e subjektit lidhur me shumën prej 312,472 (treqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, të deklaruar si të përdorur gjithashtu si burim për blerjen e apartamentit, e cila ka qenë gjendje në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank” në datën 31 dhjetor 2006 dhe është tërhequr dhe mbajtur *cash* në banesë gjatë vitit 2007 (e padeklaruar) dhe në vijim e përdorur në vitin 2008, duke e konsideruar si situatë negative financiare të vitit 2008 shumën prej - 312,472 (treqind e dymbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh.

9.6 Lidhur me situatën negative financiare të krijuar në vitet 2012 - 2016 për shkak të shpenzimeve të shkollimit të vajzës, trupi gjykues pranoi shpjegimet e subjektit dhe faktin se ato janë financuar

nga xhaxhai i saj, duke ndryshuar kështu situatën negative financiare të familjes së subjektit të rivlerësimit.

9.7 Lidhur me situatën negative financiare të mbetur në total ndër vite, në vlerën 500,000 (pesëqind mijë) lekë, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë jetën modeste të subjektit dhe familjes së saj, si dhe referuar edhe rasteve të tjera të mëparshme të rivlerësimit të subjekteve nga Komisioni, nuk e konsideron atë të mjaftueshme për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

16. Në përfundim të vlerësimit të pasurisë, në raport me barrën e provës, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime të sakta në deklaratën *Vetting* për kriterin e kontrollit të pasurisë. Pasaktësitë e konstatuara gjatë hetimit lidhur me veprime të kryera nga bashkëshorti i saj, u vlerësuan nga trupi gjykues se nuk lidhen me subjektin e rivlerësimit dhe veprimtarinë e saj si prokurore, e nuk mund, e as duhet, të ndikojnë në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, në këndvështrim të procesit të saj të rivlerësimit. Nga vlerësimi i provave dhe shpjegimeve në raport me deklaratën *Vetting*, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLI I FIGURËS

17. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), si institucion kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin figurës, ka paraqitur në Komision Raportin nr. ***, datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me Vendimin nr. ****, datë 7.7.2020, të KDZH-së, sipas të cilit rezultoi se:

- *Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.*
- *Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

18. Për sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri).

19. Komisioni, lidhur me kriterin e figurës, nuk konstatoi *indicie* apo informacione, sipas kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbënin dyshim të arsyeshëm gjatë kryerjes së hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

20. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti ka plotësuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

21. Ky raport profesional është përgatitur bazuar në raportin e sjellë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimet e paraqitura në Komision, si dhe kriteret e vlerësimit, të parashikuara nga legjislacioni që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

22. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të subjekteve në proces rivlerësimi”, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit Lindita Male (Ziguri), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

23. Në analizë të përbashkët të dosjeve të vlerësuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Për sa i përket vlerësimit në aspektin profesional, rezulton se ka shfaqur aftësi të mira në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor dhe logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta. Gjithashtu, ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit profesional.

24. Aktet e përpiluara paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor. Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme.

25. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit Lindita Male (Ziguri). Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, në asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

DENONCIMET E PUBLIKUT

26. Në Komisionin janë protokolluar 5 (pesë) denoncime për subjektin e rivlerësimit.

1. Denoncimi i shtetasit V.P., regjistruar me nr. *** prot., datë 15.3.2018, drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, me objekt “vlerësim pasurie, kontroll figure dhe aftësi profesionale”.

Komisioni, pasi administroi denoncimin, nuk evidentoi të dhëna lidhur me shkelje ligjore për subjektin e rivlerësimit, sipas kriterëve të rivlerësimit, sikurse kërkohet në pikën 2, të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Denoncimi i shtetasit A. Q., regjistruar me nr. *** prot., datë 16.3.2018, drejtuar subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi ka referuar se subjekti nuk ka zhvilluar hetime lidhur me kallëzimin e tij ndaj gjyqtarës A.A. dhe sekretarës së saj A.D, për manipulim të procesverbaleve të seancave gjyqësore.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, e cila ka sqaruar se:

“Së pari, në praktikën time të punës komunikimet me subjektet i ezauroj vetëm në rrugë zyrtare sipas kërkesave procedurale dhe normave etike, pa ndërmjetës, sidomos punonjës të administratës që nuk kanë lidhje me k/sekretarinë si zyrë përgjegjëse e marrëdhënieve me ta. Për marrëdhëniet

me publikun kam zbatuar dhe urdhërimet e brendshme të drejtuesit të prokurorisë, që kontaktimi të kryhet mbi bazën e kërkesave të regjistruara në protokoll.

*Së dyti, nga ana e shtetasit A. Q. nuk është depozituar kallëzim sikurse pretendon, por vetëm një fletë formati e titulluar si e tillë, e pashoqëruar me asnjë lloj dokumentacioni tjetër. Në shkresën “kallëzim” të bërë hyrje me nr. ***, datë 6.4.2016, janë bërë shënimet respektive me datë 11.4.2016, të drejtuesit dhe zv. drejtuesit për vlerësim dhe në vijim më ka kaluar mua.*

*Së treti, i është kërkuar informacion Gjykatës Administrative Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2016, për statusin e çështjeve gjyqësore me palë A. Q., prej nga është marrë dijeni se çështja në fjalë (nr. ****, datë 30.3.2016) ishte në proces gjykimi mbi një kërkesë të bërë prej tij për rivendosje në afat të ankimit kundër Vendimit nr. ***, datë 4.3.2016, me gjyqtare A. A. dhe sekretare gjyqësore A. D. (shkresa nr. *** prot., datë 25.4.2016).*

Objektin e kërkesëpadisë e përbënte dëshmipërblimi lidhur me një masë sigurimi “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” të caktuar ndaj A. Q., në një procedim penal që ishte dërguar për gjykim dhe në përfundim ishte vendosur pushimi i çështjes në ngarkim të tij për veprën penale “prishje e qetësisë publike”, të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal.

*Së katërti, bazuar në këto të dhëna, në mungesë të gjetjeve të indicieve për të regjistruar kallëzim penal, është njoftuar zyrtarisht A. Q., që në përfundim të procedurave gjyqësore së bashku me dokumentacionin përkatës të paraqitej për të bërë kallëzim sipas kërkesave të nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale (shkresa nr. *** prot., datë 17.5.2016).”*

Subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, kopje të njësuar të praktikës që lidhet me kallëzimin e paraqitur nga kallëzuesi A.Q., regjistruar me nr. *** prot., datë 6.4.2016, të vënë në dispozicion sipas kërkesës datë 26.11.2020, të subjektit, drejtuar Prokurorisë Tiranë.

3. Denoncimi i shtetasit P. B., regjistruar me nr. *** prot., datë 29.10.2018, drejtuar 4 subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi ka bashkëlidhur dokumentacionin⁵², nga administrimi i të cilit duket se ankohet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal të datës 13.6.2017 lidhur me kallëzimin penal nr. ****.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, e cila ka paraqitur një përmbledhje të detajuar lidhur me kallëzimin penal nr. ***/2017, si dhe veprimet procedurale hetimore, për të cilat, pas vlerësimit në tërësinë e tyre, në përfundim është vendosur mosfillim procedimi me Vendimin e datë 13.6.2017. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se vendimi i është njoftuar zyrtarisht kallëzuesit me shkresën nr. ****, datë 7.8.2017, i cili ka zgjedhur të ushtrojë të drejtën e ankimit në gjykatë.

Pas ankimit të bërë prej tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e mosfillimit të procedimit lidhur me kallëzimin nr. ***, i vitit 2017, duke marrë formë të prerë, pa u ankimuar në shkallën e dytë.

Subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës kopje të njësuar të dosjes penale nr. ***/2017, lidhur me kallëzimin e kryer nga shtetasi P. B., pjesë e së cilës është edhe vendimi i formës së prerë me Nr. *** Akti, datë 25.9.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Denoncimi i shtetasit M.K., regjistruar me nr. *** prot., datë 29.10.2018, drejtuar disa subjekteve, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, të cilët i denoncon se kanë shkelur ligjet me dashje dhe kanë marrë pronën duke e nxjerrë jashtë banesës.

⁵² Ankim datë 16.8.2017, vendim mosfillim procedimi datë 13.6.2017, si dhe dokumenti ku mbështet kallëzimin.

Komisioni, pasi administroi denoncimin, nuk evidentoi të dhëna lidhur me shkelje ligjore për subjektin sipas kriterëve të rivlerësimit, sikurse kërkohet në pikën 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. Denoncimi i shtetasit A.D. regjistruar me nr. **** prot., datë 20.3.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit, të cilën e denoncon për vendim të padrejtë lidhur me kallëzimin e paraqitur ndaj Arkivës së Shtetit, për konsumim të veprës penale, për shkak të nxjerrjes së dokumenteve nga arkivi në emrin e denoncuesit, pa qenë ai vetë. Subjekti ka bashkëlidhur vendimin e mosfillimit të procedimit, si dhe korrespondencën e mbajtur me Arkivën Qendrore dhe Prokurorinë Tiranë.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit, e cila ka sqaruar se:

*“Vendimi me datë 31.7.2017 “Për mosfillimin e procedimit penal” në lidhje me kallëzimin nr. *** datë 25.7.2017, është marrë pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kallëzuesi, i cili për vendimmarrjen është njoftuar zyrtarisht nëpërmjet dërgimit të kopjes me postë, duke zgjedhur të mos ushtrojë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Vendimi është marrë pasi në materialin kallëzues nuk janë gjetur indicie dhe aq më pak prova të tilla që të përbënin bazën e të dhënave të nevojshme për regjistrimin e një procedimi penal sipas kërkesave të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka paraqitur një përmbledhje të fakteve të kallëzimit dhe të veprimeve të ndjekura në kuadër të hetimit”.

Lidhur me thelbin e denoncimit, i cili sipas denoncuesit ka qenë tërheqja e dokumenteve të pronësisë nga persona të tjerë, subjekti ka sqaruar se nuk qëndron, pasi vetë shtetasi A. D. deklaroi se për tërheqjen pranë Arkivës të Shtetit dhe përfaqësimit të grupit prej 10 trashëgimtarësh (fëmijë dajë/hallë) të pronave të shtetasve I.D.dhe I.M.D. kishin pajisur me prokurë të posaçme djalit e hallës, K.S., me banim në Tiranë, të cilën e ka revokuar në datën 17.10.1994, duke marrë vetë përsipër përfaqësimin, akt i cili ndodhet në dosjen hetimore.

Subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provës, kopje të njësuar të dosjes penale lidhur me kallëzimin nr. ***/2017, të kryer nga shtetasi A.D..

27. Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport edhe me dokumentacionin mbi denoncimet, trupi gjykues nuk vëren rrethana për fakte që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore apo të dhëna dhe *indicie* për subjektin, të cilat mund të merren në konsideratë në vlerësimin e saj profesional, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

28. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “e aftë”. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

29. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, bazuar në analizën e mësipërme dhe në konkluzionet e arritura për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, si dhe në konkluzionet për dy kriteret e tjera të rivlerësimit kalimtar të tij, atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka arritur:

- a) nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

30. Nga vlerësimi në tërësi i dosjes së rivlerësimit për subjektin Lindita Male (Ziguri) vlerësohet se ajo nuk ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 12.1.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi Komici

Kryesues

Xhensila Pine

Relatore/kundër

Valbona Sanxhaktari

Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha